



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 02/24
Rahovec, 20.2.2024

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e dytë (2), e cila do të mbahet më:
29 shkurt 2024 (enjte), me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
4. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
5. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat e konkurrimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë dhe juridikë, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet, P- 02302-0 dhe 02299-0, ZK- Rahovec.
7. Raporti nga Zyra e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 dhe diskutimi i planit të veprimit;
8. Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2022;
9. Raporti i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023;
10. Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;
11. Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit;

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni



Komiteti për Politikë dhe Financa

Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, si dhe nenit 32 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e vet të mbajtur më **20.2.2024**, për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
3. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
4. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat e konkurrimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik, deri në 25 (njëzete pesë) vite, P- 02302-0 dhe 02299-0, ZK- Rahovec.
6. Të ndryshme.
- 7.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa i drejtohen kuvendit komunal me këtë:

R E K O M A N D I M

1. Pika e parë është aprovuar në mënyrë unanime, pa ndonjë vërejtje;
2. Pika dytë e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit, ku në mbledhje të Kuvendit të jepet emri i një anëtari nga radhët e PDK-së;
3. Pika e tretë e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit për shqyrtim;
4. Pika e katërt e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit për shqyrtim dhe është rekomanduar që të vije edhe lista me emrat e propozuar për emërtim të rrugëve;
5. Pika e pestë është rekomanduar që t'i kalohet Kuvendit për shqyrtim;
6. Në pikën “të ndryshme”, nuk ka pasur ndonjë diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit

Arber Zenuni



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.01.2024**, me fillim në orën **10:20**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të parë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02343-0 me pronën e institucionit qendror, P-01422-5, zona kadastrale - Rahovec;
4. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02280-1 me pronën e institucionit qendror, P-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;
5. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, në Komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZhK), 2023-2031;
7. Shqyrtimi i plotësim - ndryshimi të vendimit 01 Nr.167/23, datës 27.12.2023;
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së kuvendit për vitin 2023;
9. Informatë rreth aktiviteteve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), për vitin 2023;
10. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar, janar – dhjetor 2023;
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Performancës Komunale për vitin 2022;
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
13. Shqyrtimi i informatës mbi realizimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale, gjatë vitit 2023;
14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Komunal të fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë i kemi edhe dy pika shtesë që janë kthyes nga MAPL për arsye të gabimeve teknike në vite: **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit dhe Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Lokal për Biodiversitet**; Atëherë, këto dy pika shtesë i vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohen dy pikat shtesë. Tani në votim e vendosim rendin e ditës me 16 pika, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A kemi ndonjë diskutim apo koment nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet pika e parë.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Edona Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, kryesues, kolegë kuvendarë. Me 16 janar 2024, në faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit është postuar një lajm shumë i mirëpritur për femrat e komunës sonë: “Kryetari Latifi përmbush zotimin public me 500€ për çdo lindje”. Nga janari i këtij viti, çdo lindjen në repartin e maternitetit në QKMF në Rahovec, do të mbështetet me 500€ nga Komuna e Rahovecit. Pothuajse në çdo seancë është ngritur si çështje shqetësuese tema rreth kushteve jo të mira në QKMF. Është e papranueshme të bëni thirrje për lindje përderisa nuk ka kushte esenciale. Pas një vizite të shkurtër në këtë qendër, (edhe pse ishte vështirë të marr informata për shkak të politizimit dhe frymës së AAK-së aty brenda), kuptova që brenda stafit mungon një neonatology. Sipas drejtorit Elbunit Kryeziu, shërbimin e neonatologut e kryen një pediatër. Drejtoreshë, mos harro se kemi të bëjmë me dy jetë dhe këto zëvendësime sigurisht i ndalon edhe ligji. Në fund kam disa pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë: Meqenëse më lart e ceka mungesën e kushteve elementare dhe mungesën e stafit. Atëherë, a ia vlen të rrezikohen dy jetë për 500€? Në rast të rrezikut si për nënën ashtu edhe për bebën, a ka staf adekuat që përkujdesen? Apo keni për zgjidhje që t’i adresoni jashtë Rahovecit? A mund të na jepni një informatë pse kemi numër kaq të vogël të lindjeve në qytetin tonë, duke e ditur që për secilën femër të komunës është e konvencionale që lindjen ta kryejnë brenda qytetit.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar kryetar, zv. kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media. Dua të ndërlidhem me të drejtën e shfrytëzimit të shujtave të mësimdhënësve, që tani nga ministria përkatëse përgjegjësitë janë bartur nëpër komuna për periudhën 2017-2021, 2021-2023. Jam paksa i shqetësuar, pasi që në familjen time, bashkëshortja është mësimdhënëse dhe e vërejtëm një mospërgjegjësi nga Drejtoria për Arsim në komunë. Në dokumentet e lëshuara nga Drejtoria e Arsimit, në tri dokumentet zyrtare asnjë nuk përputhet me njëri tjetrin edhe pse ka pasur kohë bukur të mirë për t’i mbledhur orët apo ditët e mësimi. Faktikisht ka shumë ankesa prej mësimdhënësve të dëmtuar financiarisht, në rastin që po flas dëmi gati 500€ për bashkëshorten. Me datë 17 janar 2022 në dokumentin e lëshur nga DKA, në tabelë nëse i mbledhim ditët e punës për secilin vit, duhet të dalin 600 ditë pune. Nuk e di se në çfarë forme është bërë kjo mbledhje nga zyrtari juaj, duke e cekur këtu që janë 487 ditë. Me këtë vërejtje, jam interesuar që ta marr edhe një herë një dokument zyrtar në shkollë. Aty mora një dokument të ri dhe të vulosur me 602 orë. Shkuam edhe një herë në drejtori për të vërtetuar se ku qëndron gabimi, këtu na japin 698 ditë, d.m.th ka papërputhshmëri në tre vende. Këtu dëmtohen direkt mësimdhënësit, nëse ata kanë punuar dhe i takon kjo e drejtë, atëherë nuk e di se kush po e bën mbledhjen e këtyre informatave. Tabela është e shkruar nga dikush dhe për këtë arsye nuk jemi rastësisht me PISA aty ku jemi. Për këtë dëm dikush duhet të ketë përgjegjësi, sepse mjetet nuk janë bartur nga gjepi vetanak, por është obligative nga buxheti.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, kolegë anëtarë të kuvendit, qytetarë, medie. Dua të ndërlidhem me seancën paraprake, meqë nuk kam pasur mundësi të deklarohej për raportin vjetor të punës të kryetarit. Aty janë listuar si çdo vit prioritetet dhe synimet e kryetarit, që mund t’i quaj “dëshira në letër” sepse po të njejtat janë duke u përsëritur për çdo vit. Nëse e bëjmë një përmbledhje të këtij viti të qeverisjes komunale nga pushteti aktual, mund të themi se niveli i zhvillimit ekonomik dhe menaxhimi i komunës, nuk janë në nivelin e duhur. Nëse analizohet raporti i vitit 2023 dhe e ndërlidhim me planin e punës për vitin 2024, vërejmë se, në shumicën e prioritetëve dhe synimeve kemi përsëritje dhe kjo i bie që nuk pritet të ketë realizim të këtyre projekteve. Në këtë asamble komunale, jemi dëshmitarë të miratimit të buxhetit komunal për vitin 2024. Për këtë buxhet të miratuar, pata deklaruar që nuk do të sjellë zhvillim ekonomik as nxitje të zhvillimit ekonomik, sepse nuk përmban projekte të reja kapitale, por vetëm vazhdimësi e projekteve të vjetra. Nëse flasim për menaxhimin e përgjithshëm të komunës, atëherë duhet t’i kujtojmë dy raportet e fundit të auditorit të përgjithshëm, që tregojnë nivelin e menaxhimit komunal në administrimin e kompetencave financiare. Shpresoj që këto prioritetet dhe synime të paraqitura në planin e punës për 2024 që prekin fushën e menaxhimit, të realizohen në këtë vit. Në fund, kryetari të komunës dëshiroj t’ia parashtoj dy pyetje: Pse nuk janë listuar synimet e qeverisjes komunale në raport me mundësitë buxhetore? Për këto dy vite të qeverisjes, a keni marrë ndonjë masë apo veprim ndonjë përgjegjësi për dështim të projekteve dhe synimeve që nuk janë arritur gjatë këtyre dy viteve, apo e gjithë përgjegjësia e menaxhimit bie mbi ju? Po ashtu edhe për drejtorët e ekzekutivit i kemi paraqitur kërkesat nga viti 2023, të cilat presim që në këtë vit të realizohen, sidomos

nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, e Arsimit dhe e Bujqësisë, që prej tyre presim rezultate, që kërkesat tona mos të mbesim vetëm kërkesa.

Kryesuesi: Faleminderit Lirigzon! Një vërejtje të vogël e kam! Diskutimi ishte paksa jashtë rendit të ditës, sepse sot nuk diskutohet plani vjetor i kryetarit. Kërkoj mirëkuptim që në pikën e dytë: Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve, të adresoni vetëm pyetjen dhe jo të merreni me diskutim të raporteve që janë votuar në seancat e kaluara.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kryesues, nënkryetar, kolegë, drejtorë, medie, qytetarë. Diskutimi im ka të bëjë me subvencionimin për lindjet që ndodhin në QKMF – Rahovec. Besoj që arsyeja e këtij vendimi, siç e ka përmendur edhe kryetari, që të forcohet QKMF-ja. Hapi i parë ka qenë renovimi total që ka ndodhur në repartin e maternitetit në QKMF dhe ai që e ka vizituar i ka parë nga afër investimet që kanë ndodhur atje. Hapi tjetër, një statistikë i publikuar në Agjencionin e Statistikave, që tregon se sa lindje ka në QKMF... Është gabim kjo ndërhyrje kryesues, sepse jam në diskutim dhe diskutimet janë të lira, si dhe fjalën e lirë nuk na ndalon askush. Jeni duke bërë gabim të madh këtu. Për diskutimet brenda rendit të ditës janë pikat e veçanta, pika e dytë është për diskutime, për pyetje dhe përgjigje.

Kryetari: Përshëndetje kryesues! Përshëndetje anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, përfaqësues të KFOR-it, medie, shoqëri civile. Është një paqartësi e madhe. Nëse dëshironi e vendosim edhe një pikë të rendit të ditës për diskutime, por nëse pika e rendit të ditës është pyetjet dhe përgjigjet, ju lutem që ta mirëkuptoni kryesuesin të gjithë. Askush askujt nuk mund t'ia ndalojë fjalën, por që, ne duhet të jemi në rend dite. Nëse dëshiroju, prej tani e vendosim një pikë të re me komente, kritika, sugjerime etj... Nëse është pika, pyetje dhe përgjigje, mendoj që diskutimet që janë bërë, janë bërë gjithmonë gabimisht. Përndryshe, unë jam i disponuar që të flas me ju sa herë të doni. Por këtu, nuk besoj që kryesuesi nuk ka të drejtë. Ka të drejtë kryesuesi, ka pasur të drejtë edhe ish kryesuesi dhe të tjerët që kanë qenë më parë.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Të nderuar anëtarë, unë jam i përzgjedhur i kuvendit me votën tuaj dhe me respekt të drejtën e fjalës e keni secili, pa keqkuptime.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, medie, kolegë asambleistë, përfaqësues të KFOR-it dhe ju të pranishëm. I kam dy pyetje, por parimisht dua të komentoj. E para ka të bëjë me atë që më prekë në profesion, rreth vendndaljes së autobusëve. E kam parë që është bërë diskutim në facebook kjo temë dhe më intereson ta di se cila është kompania që Komuna e Rahovecit ka kontratë për ndërtimin e këtyre kabinave? Sa është vlera e kontratës dhe sa kabina të tilla do të ndërtohen në Komunën e Rahovecit prej Komunës së Rahovecit? E dyta: Në debatet gjatë fushatës zgjedhore e kam potencuar që projektet e Komunës së Rahovecit përfundojnë pa pranim teknik. Një rekomandim i USAID-it ka qenë që me pranimin e pozicionit të fundit, objekti të llogaritet teknikisht i pranuar. Koha e ka dëshmuar të kundërtën dhe dëshmon që mungesa e seriozitetit të punimeve ka nxjerrë vazhdimisht dështim të projekteve apo mosmarrje të epilogut. Sistemi i ujitjes në Opterushë, është një objekt që është ndërtuar në mandatin e parë të kryetarit aktual, gjenden afër shkollës në Opterushë, ka mbetë gërmadhë, janë investuar qindra mijëra euro dhe kurrë nuk ka marrë epilog. Uji i pijes për 5 fshatrat e Anadrinit ka qenë një projekt i dështuar dhe është dashur të merret përsëri kryetari Vehapi, të bëjë gjithë sanimin e sistemit të ujit të pijes. E kemi rastin e palestrës në Rahovec, është lëshuar një funksion pa pranim teknik dhe sot i pikon kulmi. E kemi rastin e kolektorin kryesor Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe, që janë investuar mbi 400.000€ dhe deri aty është projekt i dështuar në tërësi. Dy projekte tjera më të fundit: E kemi rastin e përrockës në Celinë (që është ndërtuar në 2020 - 2021), me qëllim e kam marrë një fotografi të datës 09.07.2021. Në foto shihet në momentin kur është rritur uji, menjëherë është shembë përrocka dhe kjo nuk jam në dijeni që ka pranim teknik. Të fundit e kemi në Ratkoc, është përrocka në hyrje të Ratkocit, në krahun e majtë të binarët e trenit. Kjo kjo përrockë është gjithashtu e njëjta situatë, është projekt i punuar në 2021 dhe është shembë. Kryetar, a jep ndonjëherë dikush përgjegjësi për këtë keqpërdorim të parasë publike, sepse projektet pa epilog dhe projektet që dështojnë, unë i konsideroj keqpërdorim. Pyetja është: A keni kërkuar ndonjëherë përgjegjësi nga dikush për të gjitha këto projekte, të cilat ose nuk kanë marrë epilog, ose nuk ka kanë qëndruar fare kohës.

Kryetari: Faleminderit shumë! Po i jap përgjigjet shkurt. A duhet situacion përfundimtar apo pranim teknik? Këto gjëra janë të rregulluara me ligj dhe nuk kanë nevojë për komente. A duhet ta përcjellim cilësinë që të sigurohemi për

garancionin dy vjet (unë e kam bërë 2, sepse ka qenë vetëm 1 vit)? Natyrisht që po! Po ashtu, ka dëme edhe në projektet që kanë përfunduar, sepse ka pasur edhe avari, vërshime dhe përmbytje. Ende është një problem me sistemin e ujitjes, që është pengesë sepse është një gyp i madh kryesor. Sa i përket pritoreve, përgjigje jep Përparimi. Sa i përket ujit të pijshëm për 5 fshatrat, meqenëse ka ndodh. Kjo ka filluar në kohën e z. Qazim Qeska, ka vazhduar në kohën time (nuk është përfunduar), ka vazhduar në kohën e Idriz Vehapit (edhe pse është përfunduar, nuk është përfunduar) dhe ka përfunduar në mandatin 2017-2021, për shkak që ka ngelur Polluzha me probleme. Tani është përfunduar dhe ka ujë, gjithashtu më vie mirë që ata banorë të atyre fshatrave fuznizohen direkt nga fabrika për përpunimin e ujit - sistemi i filtrave dhe ujësjellësi funksionon shumë mirë dhe tani përgjegjësinë e ka KRU – Gjakova. Të jemi korrekt, në kohën e z. Idriz Vehapi është përfunduar një pjesë sepse projekti në Polluzhë ka marrur epilog më vonë dhe më tutje në fund ka marrur epilog edhe projekti në Pastasel pas një insistimi që e kam bërë. Po e përsëris, është një pasaktësi e madhe të flitet për një projekt i cili nuk ka ndodh në kohën time. Kolektori për fshatrat që e përmendi zotëriu, ka filluar dhe është kontraktuar në kohën e Qazim Qeskës dhe projekti kurrë nuk ka përfunduar, sepse ka pasur probleme. Kur kam ardhur unë, meqë nuk ka funksionuar, kam bërë mirë që e kam shkëputur kontratën sepse ka pasur probleme pronësore në Nagac dhe Hoçë të Vogël. Problemet pronësore që kanë qenë me ata njerëz në atë kohë, tani ata janë të gatshëm të lejojnë realizimin e projektit të ri. Dikush e ngriti një shqetësim dhe është ende këtu, sepse ka raste kur shqetësimi ngritet dhe asambleisti e lë seancën. Ne i kemi vërejtur disa veprime të quditshme që ka ndodh sa i përket shujtave, udhëtimit dhe ditëve të punës të mësimdhënësve. Po flas në parim, përndryshe përgjigjen do t'ua jep drejtori i DKA-së. E kam vërejtur edhe një tendencë të avokatët, të cilët e kanë bërë një avokim, duke hyrë nëpër shkolla për t'i kontraktuar mësimdhënësit. Nuk kanë përtuar që nëse bileta e autobusit prej Xërxe në Rahovec është 1€, t'ia bëjnë 2 apo 3€. Fatbardhësisht këto gjëra i disponojmë ne. Kjo nuk nënkupton që unë nuk jam për realizimin e kontratës kolektive dhe të drejtat e secilit mësimdhënësi. Kjo gjithashtu nuk nënkupton që ne jemi apriori të obliguar të punojmë në mënyrë arbitrare dhe ta dëmtojmë buxhetin e komunës me pasaktësi të dosjeve të mësimdhënësve. Drejtorët e shkollave kanë lëshuar dokumente ndoshta edhe me qëllime të mira, por në dokumente figurojnë ditët e punës që nuk kanë lidhje me mësimdhënien, duke shtuar numrin e ditëve të punës. Kontrata kolektive duhet patjetër të zbatohet, por duhet vetëm saktësi. Jam detyruar që të kërkoj centralizim për këtë përgjegjësi, sepse ka drejtorë të shkollave (po flas kushtimisht), që në vend se t'ia vendosin 200 ditë, ia "fut" 300 ditë. Për t'i parandaluar parregullsitë e tilla, ne e kemi centralizuar. Madje, ne kemi krijuar ekip dhe në bashkëpunim me avokatin e komunës, të sigurohemi që ndoshta është ndonjë mësimdhënësi po i merr nga dy herë. A e dini që kemi pasur raste që i kanë marrë nga dy herë? I kemi në evidencë, por është fat që i kanë kthyer pas. A duhet ta dëmtojmë mësimdhënësin? Jo! A guxojmë ta dëmtojmë buxhetin e taksapagueseve? Jo! Për këtë arsye e kam caktuar përgjegjës një ekonomist të mirë dhe tani janë bërë 3 anëtarë të komisionit që bashkëpunojnë në baza ditore me DKA-në dhe Drejtorinë e Financave. Gjithashtu tani kemi edhe raporte speciale që i mbajmë në evidencë. Konkursi letrat "Flaka e Janarit" ka dështuar sepse mësimdhënësit kanë bërë "dollovere". Konkursi ka dështuar për shkak të plagjiaturës, për 200-300€ nuk mund ta marrësh poezinë e Nolit dhe të thuash është e imja, po e them kushtimisht. I dua arsimitarët, sepse të gjithë ABC-në e kemi mësuar prej tyre, por ka edhe prej tyre që nuk lodhen për buxhetin e këtij shteti. Sidoqoftë, jam pro kontratës kolektive, por ne kërkojmë që mjetet financiare për kontratën kolektive të planifikohen nga autoritetet qëndrore të Republikës së Kosovës, sepse është sfidë e madhe që një komunë t'i paguaj 3 milion € kur nuk i posedon ato, sepse nuk ka se si t'i ketë në një kod të veçantë. Para disa viteve në repartin e maternitetit në Rahovec, brenda ditës kanë ndodhur edhe 13 lindje. Kushtet nuk ka qenë më të mira se sa që janë sot, mirëpo nataliteti ka qenë në tjetër nivel. Është e vërtetë që ka nevojë për një neonatolog. Mirëpo, ne synojmë që lindjet normale dhe pa komplikime mos të ikin diku tjetër. Në fakt, sipas ligjit aktual ne nuk kemi të drejtë të kemi fare repart të maternitetit, sepse nuk është spital. Jemi duke u munduar ta rrisim pozicionin dhe kuadrot. I kemi dy specialistë më të mirë në Kosovë për lindje, Feirzi Kryeziu dhe Ilir Kadiri. Është bërë temë e madhe kjo, duke qëndruar ditën e natën nëpër televizione vendore e të Republikës së Shqipërisë, por ka qenë premtimi i imi, nga 400 sa ka qenë në vitin e kalur. Kemi filluar me 200, sot e kemi 500€. Nëse ne, me 220€ mbulojmë shpenzimet e varrimit, i bie që me këtë i kemi dhënë përparësi lindjes dhe kjo nuk ka të bëjë absolutisht asgjë me politikë. Politikë po, por e nxitjes dhe forcimit të pozicionit të QKMF-së dhe nxitjes të atyre grave, të cilat mund t'i realizojnë lindjet e tyre normale dhe me sukses në

QKMF. Më ka shkuar mendja ta shqyrtojmë mundësinë që t'i mbështes për çdo lindje edhe specialistët, bashkë me motrat që punojnë aty. Gjithashtu e lus qeverinë e Kosovës, që shtesën që e kanë 10€ të ngritet në 40 ose 50€ dhe ta krijojë një standard tjetër të përkrahjes maksimale për familjet tona, sidomos për familjet e reja. Një kohë është përmendur një premtim që kinse çdo çift i ri që martohen do ta ketë një banesë. Te ne nuk ia kanë nisur ndërtimet, jemi ende në pritje, se unë do t'ju jap banesa çifteve të reja që martohen edhe pse qeveria nuk po iu jep, ndonëse e ka në program qeverisës. Faleminderit shumë!

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, i nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, drejtorë, monitorues të organizatave dhe KFOR-it, zyrtarë komunalë, medie, qytetarë. Unë qenkam në garë ta fitoj një banesë, por nuk e di edhe sa vjet duhet të kalojnë. Megjithatë unë deshta ta komentoj edhe atë që tha kryesuesi për pikën e dytë. Kryesues, unë e di që diskutimet për rendin e ditës i bën me kryetarin e komunës dhe kryetari e din pse kjo pikë është në rend dite. Kjo i bie që kryetari vetë po e bën rendin e ditës dhe dërgohet direkt prej zyrës së tij. Kjo pikë është e përcaktuar edhe për diskutime dhe nuk mund t'i vendoset emërtimi të ndryshme si në KPF, sepse aty anëtarët e kuvendit mund të bëjnë edhe propozime. Për këtë është pyetje dhe përgjigje, që mund t'i shtohet edhe një formë e diskutimit sepse qytetarët përmes neve i paraqesin kërkesat e tyre në komunë. Ne kemi nevojë që të shprehemi dhe të diskutojmë. Nëse ju dëshironi ta fshehni përgjegjësinë dhe në bazë të kësaj forme të na cungoni punën në kuvendi komunal, atëherë është përgjegjësi e juaja. Përndryshe, sot duhet të flas për Drejtorinë e Urbanizmit. Kjo drejtori e ka një rol shumë të ndjeshëm dhe rëndësishëm në zhvillimin e komunës sonë. Nga Drejtoria e Urbanizmit varet zgjerimi i vendbanimeve, funksionalizimi i tyre dhe çështja e ndërtimeve. Specifikisht te çështja e ndërtimit, ndërtimit pa leje, jo para 20 viteve, por për vitet 2024,2023. Kryetar, a e dini se çfarë po ndodh në Drejtorinë e Urbanizmit, sot? Për gjendjen e ndërtimeve në terren, besoj që jeni në dijeni sepse po e shihni gjatë ecjes në rrugë. Besoj që gjithashtu e dini që ka shumë ndërtime pa leje në komunën tonë! Pse? Pse komuna nuk po arrin ta zgjidhë këtë problem, kush është shkaktari? Forma e funksionimit në këtë drejtori është e njejtë qe shumë vite, e pa ndryshueshme. Ju nuk keni bërë asgjë për zhvillimin e kësaj drejtorie. Personat e caktuar, këtë drejtori e kanë bërë si biznes privat, kjo është e dhimbshme dhe e dëmshme për komunën tonë. Deri kur do të vazhdoni kështu, përveç që nuk punojnë për të mirën e institucionit, ata po e shfrytëzojnë institucionin për interesin e tyre personal, duke punuar me standarte të dyfishta. Pse ka nevojë që vendimet e thjeshta tendencozë që merren në këtë drejtori, të kalojnë edhe kah zyra ligjore dhe më pas të mos shihen shkeljet që evidentohen nga ministria përkatëse. Pse edhe pas shqyrtimit të këtyre vendimeve nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, përsëri kryetari apo drejtori nuk marrin masa disiplinore nga zyrtarëve që komunës po “ia qesin faqen e zezë”. Deri kur do të vazhdojë kështu, sepse preken qytetarët dhe komuna. A do të vendosni ndonjëherë rregull, apo do ta lejoni formën e funksionimit si në Gazimestan. Përderisa selektoni njerëz për t'i pajisur me leje (po i referohem zyrtarëve në atë drejtori), që numri i lejeve ndërtimore do të jetë i vogël, ndërsa ndërtime sigurisht do të ketë më shumë.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Përsëritet për ju, për kryetarin e komunës, nënkryetarin, drejtorët, kolegët, vëzhguesit. E kam një pyetje për drejtorin që ka qenë në Japoni, të Shërbimeve Publike, mikun tim z. Krasniqi. Në Krushë është një tender për larjen e rrugëve. Sa e di unë, 1 km ai e ka një herë në muaj. Gjithsesi, sipas informatave të fshatit, prej 24 marsit operatori nuk është dukur fare për pastrim. Është mirë që të merren masat e nevojshme, që të paktën të përmbushet kontrata. Gjithashtu kryetar, kam kërkesë që prej 24 marsit të vitit të ardhshëm ta shqyrtoni mundësinë që atë një kilometërshin e Krushës ta bëni 2 deri në 3 km dhe sipas mundësive ta bëni një herë në javë larjen, sepse pas 24 marsit aktivizohet edhe muzeu i holokaustit tonë, apo i gjenocidit në Krushë. Kërkesa e këshillit në detyrë të fshatit dhe banorëve të Krushës së Madhe është që prej muzeut “Ukshin Hoti” deri të Kompleksi i Varrezave, një herë në javë ta bëni të mundshme larjen në atë pjesë.

Valmir Gashi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, kolegë asambleistë, medie. Sot kam disa kërkesa nga banorët. Po filloj nga vendlindja ime, fshati Sopniq. Për shkak të reshjeve të shiut gjatë sezonës së vjeshtës dhe dimrit, në Sopniq është bllokuar në total kanali kullues në rrugën kryesore. Nëse ka mundësi që të shqyrtohet kjo nga drejtori i Shërbimeve Publike. Për çështjen e rrethrotullimit në mes të rrugës Pataqan – Sopniq, jam në dijeni që kjo është aprovuar, por mundësisht sa më shpejt të realizohet dhe njëkohësisht t'i evitohet problemet aty. Të shqyrtohet gjithashtu nëse mund të krijohet një hapësirë gjelbëruese në fund të fshatit,

te vendi i quajtur “Varri i Bajraktarit”. Në këtë hapësirë, banorët po hudhin mbeturina dhe do të ishte më mirë të krijohet një hapësirë me gjelbrim. Trotuari besoj që veç që nuk ka filluar të kryhet deri në dalje të fshatit. Te rruga e varrezave, një pjesë e rrugës ka mbete e paasfaltuar. Nuk është që nuk është punuar në Sopniq. Janë shtruar shumë rrugë fushore, ndriçime, janë ndërtuar 4 ura. Në media e kam parë që në Saradran të Istogut është ndërtuar një urë, në përurim kanë shkuar kryeministri me presidenten. I ftoj që të vijnë t’i prejnë shiritat edhe në Sopniq, ku gjatë qeverisjes së Smajl Latifit janë ndërtuar 4 ura. Kam kërkesë edhe nga banorët e fshatit Drenoc, drejtuar Inspektoriatit Komunal për presion ndaj KRU. Gjakovës. Kërkesa ka të bëjë për sanimin e kanalizimit në fshatin Drenoc në rrugën “Malush Gashi” sepse rruga është bërë e pakalueshme. Si dhe vazhdimin e trotuarit nga pompa e benzinës “Berisha Petrol” deri në dalje të fshatit.

Eqrem Spahiu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. Do të flas përsëri për një shqetësim që na preukupon, për ambulancën e fshatit. Me 10 qershor është bërë përurimi i ambulancës së fshatit. Prej asaj kohe, aty nuk ka kushte për punë, as për mjek, as për pacientë që shkojnë për vizitë. Përndyshe, myku ka filluar të shfaqet, betoni i mureve të bie në tokë dhe dyert nuk hapen. Apeloj për të tretën herë që të intervenohet sa më parë. Do të flas edhe për rrugën prej varrezave deri te rruga kryesore. Aty është një gropë e hapur që 3-4 muaj, e cila rrezikon çdo kalimtarë rasti.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Gjithmonë pro ndërtimit dhe zhvillimit të qytetit, e sidomos kur investimet vijnë nga qeveria dhe ministria përkatëse. Më vie mirë që grupi ynë i vogël e ka fuqinë e ndikimit sado pak te këtë organe. Në Rahovec, po vijnë investime të projekteve të mëdha për një kohë të shkurtë, ku nën udhëheqjen e mëparshme është dashur decenje për një palestër dhe ka mjaftuar me kaq. Jom gjithmonë pro zhvillimit të qytetit, por jo asnjëherë ta shëmtojmë atë. Nuk mund të rrij e heshtur dhe nuk jam servile. Para se gjithash kam mendimin tim personal, që më përfaqëson. Nuk jam servile para partisë, ministrit, kryeministrit e kushdoqoftë ai. Fjalën e kam për ndërtimin e qendrës për arte, kulturë e inovacion në Rahovec. Mendimi im është që në një pozitë kaq të volitshme në hyrje të qytetit ka mundur të ndërtohet një kryevepër që do t’i jipte Rahovecit një imazh tjetër dhe njëkohësisht do të ftonte edhe investime të tjera. Në rastin në fjalë, e kundërshtoj pamjen e objektit për shkak se përkundër mendimit të ministrit, unë mendoj që është objekt i shëmtuar. Këtij të fundit i falet se nuk është arkitekt, e çka t’ju bëjmë arkitektave që e kanë këtë shije, e vazhdojnë ta shëmtojnë vendin me “kryeveprat e tyre”. Ftoj komunën që ta bëjë ndryshimin e fasadave të objektit, sa nuk është vonë dhe me shpresë që nuk është vonë. Çështja tjetër, në seanat e kaluara kemi bërë pyetje, se çka po ndodh me qerdhet në Krushë dhe Ratkoc? Pse atë nuk po funksionalizohen dhe përgjigja ka qenë se aty po mundon inventari, e që për detyrë ta bie e ka ministria. Kanë kaluar disa muaj dhe rrjedhimisht neve na intereson që të kontaktojmë ministrinë e ta pyesim pse ky inventar nuk po sigurohet. Përgjigja e tyre ka qenë që qerdhet janë ndërtim i komunës dhe nuk i takon ministrisë për funksionalizim dhe furnizim me inventar, por komuna e ka për detyrë. Ftoj komunën që ta qartësoj këtë pjesë dhe mos të vijnë projektet në pasivitet deri në degradim të tyre.

Kryetari: Faleminderit! Besoj që për detajet që i takojnë lejeve ndërtimore dhe për çështjet e organizimit apo mosorganizimit më të mirë të kësaj drejtorie, përgjigjet drejtori. Në fushë të Kosovës ka ndodh beteja e Osmanëve me popujt ballkanik dhe gazimestani tani është një pjesë e asaj trashëgimie, e cila shumë probleme i ka sjellë këtij vendi. Ju lutem të jeni më të përmbajtur, Gazimestani është pjesë e Republikës së Kosovës. Aty është Tyrjba e Sulltan Muratit. Me 28 qershor, atje shkojnë plot nacionalist për “pelegrinazh” dhe flasin palidhje, duke u munduar t’i bëjnë telashe shtetit tonë. Gjithmonë komunat kanë nevojë për përkrahje të qeverisë, por përkrahje më të vogël, komuna e Rahovecit dhe komunat e Kosovës nuk kanë pasur kurrë dhe është mirë ta evidentoni. Fatkeqësisht, unë punoj ende me projekte të qeverisë Haradinaj dhe qeverisë Hoti. I kemi dy projekte të reja: Përkrahja për qendrën për kulturë, rini, arte dhe inovacion dhe i kemi një pjesë bukur të mirë të financave për sivjet. Secili prej nesh e ka një bazë elektorale, unë e kam Komunën e Rahovecit, sepse ne jemi autoritete dhe jemi në shërbim të qytetërëve të Komunës së Rahovecit. Te inventari për qerdhe: Ne edhe shkollën në Fortesë e kemi ndërtuar me buxhet të komunës, ndërsa inventarin e bie ministria dhe ky është standard të cilin vetë ata e kanë vendosur. Ne e kemi ndërtuar shkollën në Hoçë të Vogël dhe Brestoc, por inventari ka ardhur prej ministrisë. Gjithashtu kjo ka ndodhur edhe te shkolla në Kaznik dhe Retijë. Qerdhet i kemi ndërtuar ne me buxhetin tonë, por inventarizimi bëhet nga ministria. Ky nuk është

problem vetëm në komunën tonë. Në të gjitha komunat ka qerdhe të ndërtuara nga komunat dhe janë të bllokuara për shkak të mungesës së inventarit. Ju kam thënë që është lajm i mirë që është nënshkruar kontrata dhe në planin dinamik është e përcaktuar që brenda një periudhe 3-mujore (nëse nuk gaboj), duket të inventarizohen të gjitha qerdhet publike. Zyrtarisht kanë thënë që brenda dhjetorit do të kryhet kjo punë, tani kanë thënë që deri në fund të janarit. Nëse është data 31 janar dhe po insisto që të inventarizohen qerdhet nga ministria, ose le të tregojnë se çfarë hapa duhet të ndërmarrim tutje. Dy vite e gjysmë kalun dhe nuk janë në gjendje ta zbatojnë një kontratë dhe t'i inventarizojnë qerdhet, e në anën tjetër ne e kemi edhe personelin e gatshëm, pra, edukatorët janë pranuar në punë. Te ngjyrat e fasadës që i përmendi zonja, në rregull, ndoshta aty mund të bëhen ndryshime, por është një projekt shumëfunksionalë dhe do të bëjë zgjidhje për shumë veprimtari të rëndësishme. Ministrin e kam falënderuar, që megjithatë një projekt po përkrahet mirë. Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport i jep 2.5 milion€. Në çiftëse ngjyrat ia shtojnë bukurinë, besoj që mund ta bëjmë ndonjë ndryshim që edhe atyre që sot nuk iu duket bukur, t'i pëlqejë më shumë.

Drilon Mustafa: Përshëndetje kryesues, kryetar, të nderuar asambleistë, medie, drejtorë, të pranishëm. I kam dy pyetje dhe sigurisht pa i komentuar nuk mund t'i realizojmë edhe pyetjet. Një pyetje e kam për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, desha ta pyes rreth asaj nëse ka ndryshuar ndonjë gjë në projektin e qendrës inovative. Kur është bërë gurëthemeli i saj me 1 nëntor, asnjë asambleist i Vetvendosjes nuk ka qenë i pranishëm dhe të gjithë prej tyre e kanë përqeshë duke e përshkruar si një shtëpi private. Kur është hapur konkursi për projektim, unë kam qenë kandidat, e kam dorëzuar projektin tim i cili nuk ka fituar, sot xhelozoj paksa, por përsëri më pëlqen ky më shumë se sa i imi që e kemi bërë në atë kohë bashkë me kryesuesin. Disa që as që nuk ka provuar dhe tentuar të projektojnë diçka, sot e përqeshin një projekt të një profesori të tyre. Mendoj që nuk duhet kështu, sepse nuk ka bazë as asgjë. Pyetja është çka ka ndryshuar projekti, me këtë që e prezantojë ministri? Pyetja e dytë ka të bëjë me Drejtorinë e Urbanizmit: Për drejtorin e Urbanizmit kam një kërkesë, që në buxhetimin e vitit 2025 të përfshihet digjitalizimi i drejtorisë, gjë e cila kursen qytetarët në shpenzime. Pyetja e asambleistit koleg për Drejtorinë e Urbanizmit, është mirë t'i drejtoheni Drejtorisë së Inspektoriatit sepse Drejtoria e Urbanizmit nuk merret nëse objektet ndërtohen me apo pa leje, por është e obliguar ta lëshojë lejen, nëse ne aplikojmë. Këto procedura “jo po ia jep Drilonit, e atij jo” nëse e digjitalizojmë mendoj që përfundon kjo punë.

Dafina Gashi: I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, drejtorë, kolegë, monitorues, medie, qytetarë. Në seancën e kaluar kur është prezantuar plani i kuvendit është paraparë që në këtë seancë të jenë edhe raportet e komiteteve. Quditërisht në këtë seancë dy prej raporteve të komiteteve nuk janë në rend të ditës. Në fakt për Komitetin për Arsim nuk është qudi, sepse gjatë tërë vitit 2023 nuk e kanë organizuar asnjë mbledhje. Nuk jam në dijeni pse ky komitet nuk ka qenë funksional, por shpresoj që kryesuesja e komitetit do të përgjigjet me një shpjegim. Sa i përket Komitetit të Shëndetësisë, mesiguri kanë qenë të zënë dhe nuk e kanë pasur raportin e gatshëm për këtë seancë. Në këtë seancë e kam këtu afër një top, është i ri (siç po e shihni). Për disa që kanë shprehur interesim për të luajtur, por nuk dijnë të luajnë. Do t'ja dhuroj këtë top që ta ketë mundësinë të mësohet. Derisa të mësohesh ndoshta kompleksi sportiv do të përfundojë. Faleminderit!

Defrim Kafexhiu: Faleminderit shumë për topin! Ka mbetë të përfundohet edhe fusha dhe unë të vazhdoj të luaj.

Kryesuesi: Faleminderit Dafina Gashi! Faleminderit edhe për këtë dhuratë për Defrim Kafexhiun.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, faleminderit për përgjigje lidhur me pyetjen që e parashtrova. Në përgjigjen e zgjeruar që e mora, faktikisht akuza që m'u drejtua kinse kur parashtroj pyetje, më pas nuk jam në seancë. Kryetar, unë jam këtu me dokumente zyrtare të DKA-së. Këto dokumente dallojnë njëra nga tjetra, përveç që dallojnë, këtu në tabelë janë 5 mësimdhënës të cilëve u janë mbledhur ditët e punës. Nga këta 5, 2 janë gabim, që i bie 40% është huqje në kalkulum në orë. Kjo huqje është dëm direkt financiar, janë mjetet e taksapagueseve që mësimdhënësve me ligj u takon t'i marrin. Po ashtu, cekët edhe shumë akuza që janë vërejtur paraprakisht gjatë përpilimit të ditëve të punës nga drejtorët përkatës, nëpër shkolla të ndryshme. Në bileta të autobusëve, sikur që disa paskan dashtë t'i marrin nga dyfish. Nëse janë këto keqpërdorime janë instancat më të larta dhe nuk bën t'i fshehim. Ky dokument që është tani edhe afatin e ankesave nuk e ka valid sepse pas 3 viteve ankesat nuk lejohen të bëhen. Kjo zhagjitje kaq e madhe nuk është e rastësishme.

Kryetari: Asnjë keqkuptim! Nuk po akuzoj, bile ty hiç se hiç. Të gjitha detajet për këto gjëra nuk janë për kuvend, sepse shqyrtohen edhe në trupa të tjerë: Gjykata, avokati dhe komisioni prej 3 anëtarëve. Këtë çështje nuk duhet të bëhen publike, sepse shteti ynë ka mekanizma që i trajton me kujdes. DKA-ja nuk ka pasur kapacitete t'i analizojë të gjitha dhe i ka besuar ndonjë drejtori të shkollës, apo sindikate të caktuar. Tani janë krijuar mekanizma që bëjnë verifikim, që neve na siguron që askush nuk merr dy herë dhe nuk shpëton më diçka që ka mundur të shpëtojë në mënyrë të pavetëdijshme për shkak të mirëbesimit. Zbatimi i kontratës kolektive dhe marrja e benefiteve nga mësimdhënësit sipas kontratës kolektive do të jetë me një standard më të lart dhe pa gabime edhe pse ende nuk e kemi të qartë deri në fund, se cilat do të jenë pasojat përfundimtare të zbatimit të kontratës kolektive.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve kryesues, kryetarin, stafin e tij, anëtarët e kuvendit, gazetarët, monitoruesit. Unë dua të lidhem me dy çështje: Këtu u ngritën disa çështje prej disa anëtarëve kolegë të kuvendit dhe pyetjet ishin konkrete rreth cilësisë jo të mirë të kryerjes së projekteve. U prekën edhe qeverisjet tjera, që ndoshta më mirë është të flasim për ne këtu që jemi duke qeverisur se sa për të kaluarën. Konkretisht për qeverisjen e PDK-së, nën udhëheqjen e të nderuarit Qazim Qeska. Mund të flas me përgjegjësi sepse edhe atëkohë kam qenë anëtar i kuvendit, që projekti i ujit të pijes për 5 fshatra ka qenë një nismë shumë e mirë. Projekti ka vazhduar aq sa ka pasur buxhet dhe mjete. Mund të them me përgjegjësi që për aq sa është punuar, punimet kanë qenë cilësore. Punimet dhe vazhdimet e projekteve do të jenë gjithmonë sa të ekzistojë njerëzimi dhe qeverisjet komunale janë të obliguara t'i vazhdojnë projektet e mbetura. Ne duhet të fokusohemi te projektet që kanë përfunduar së fundmi, e tha edhe Burim Krasniqi që duhet të kenë qëndrueshmëri. Nuk mund ta akuzojmë dikë, sepse edhe në vendet më të zhvilluara ndodhin avari dhe dëmtime të ndryshme, prej furtunave dhe vërshimeve të ndryshme. Me rëndësi të madhe është që projektet duhet të kthehen në gjendjen siç kanë qenë nga kryerësi i punimeve. U përmend në Ratkoc dhe Celinë që ka ndodhur kjo gjendje, mirëpo ai që i ka kryer punimet duhet të jep llogari. E kam edhe një pyetje të veçantë, kemi të bëjmë me drenazhimin e tokave. Drejtor, drenazhimi është në përfundim, më vie mirë. Pyetja është, ku e ka derdhjen drenazhimi? (sepse çdo drenazhim duhet ta ketë pikën e derdhjes). Jam pak i shqetësuar që prej Fortesës kur të dalim në Celinë e keni ndërtuar një kanal, quditërisht gypi që është nën rrugë është i mbyllur me dhe, ujërat që vijnë nga shpati lart dalin mbi sipërfaqe të asfaltit dhe ecin deri sa kanë mundësi. Kanali për çka është ndërtuar? Sigurisht për ta bartur ujin dhe gypi që është i mbyllur (mbi 1 vit) është duke e dëmtuar edhe rrugën edhe nuk është funksional. Kërkoj përgjigje konkrete dhe projektet të bëhen ashtu si i ka hije.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse u përmend Komiteti për Shëndetësi ka kolegja e nderuar, Dafina. Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka qenë funksional gjatë tërë vitit dhe janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Në asnjë mbledhje kryesuesja nuk ka munguar. Sa i përket asaj që është shtyer raporti, kam qenë jashtë vendit në momentin kur e kam pranuar emailin. Raporti është dashur të dërgohet fizikisht, mirëpo nëse ka interesim nga kolegja, raportin mund ta prezantoj edhe tani sepse e kam të gatshëm.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Pasiqë nuk mora përgjigje nga kryetari rreth kërkesës sime, po e bëj një koment. Nuk jam përzier asnjëherë në punën e doktorit dhe mjekësisë, por është folur shumë për këto lindjet 500€. Mendoj që ne si kuvendarë dhe ju si ekzekutivë mund ta japim një kontribut shumë më të madh. Mund ta marrim një vendim më të mirë për motivim më të madh. Po flas për vete që nëse vendosi edhe për një fëmij me grua, do ta bën lindjen në QKMF në Rahovec, jo për 500€, po thjesht për motivim.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë, të pranishëm në sallë. Në gjiro e përditshme që po i bëj në komunë, gjërat më shumë që vërehen, gjërat që krijojnë një shije të hidhur te unë dhe te të gjithë ata që e praktikojnë këtë rutinë, janë mbeturinat. Arsyetime si për çdo problematikë, besoj që keni edhe për këtë. Njëjtë si për arsyetime që ka çdo herë për problematika, ka edhe zgjidhje për çdo problematikë. Ndonëse arsyetimi është më i lehtë se zgjidhja, nuk duhet ta praktikojmë pa vend, kur jemi në ekzekutiv. Ekzekutivi është i rëndë, është për punë të rënda kryesisht. Në seancën e kaluar kam bërë pyetje në drejtim të Inspektoriatit. Drejtoresha nuk është këtu dhe nuk kam marrë përgjigje. Çfarë po bëhet për hudhjen e mbeturinave, sa dënime janë bërë dhe sa raportime ka pasur në këtë drejtim? Kuptohet, në radhë të parë të përgjegjshëm duhet të jenë banorët, andaj nga këtu i bëj thirrje banorëve, nëse fjala ime zë vend sado pak në mendjen e tyre. Ta ruajnë ambientin, ta ruajnë vendin e tyre, rrugët e të cilit dita e ditës po bëhen si shportë për mbeturina. Si shportë e vetmuar dhe e lënë

në harresë nga ata që ikin, e lënë në harresë nga ne që qëndrojmë, nga ne që hudhim papërgjegjshëm dhe e lënë në harresë nga ata që janë në krye. Atyre që janë në krye, këto veprime të papërgjegjshme po ia kujtojmë kohë pas kohe. Ekzekutiv i nderuar, sot po iu kujtoj që gjendja nuk është e mirë rrugëve, drejtuar fshatrave – rrugëve transit, rrugë të cilat përdoren si deponi për mbeturina. Gjendja nuk është e mirë as në rrugët e zakonshme nga hedhja e vazhdueshme nga të papërgjegjshmit. Disa prej masave që duhet të merren janë: Dënimet e shpeshtuara dhe të rritura pa vërejtje paraprake, vendosja e kamerave në bashkëpunim me policinë nëpër këto vende dhe evidentimi të bëhet përmes kamerave, rritja e fushatës në shkolla për ruajtjen e ambientit dhe shpeshtimin e kësaj fushate. Të gjenden forma të ndryshme për emancipim në këtë drejtim, kuptohet që duhet edhe investim financiar. Prandaj ekzistojnë të gjitha këto drejtori, që secili drejtim të rregullohet. Ju ftoj që të merreni me këtë problem të theksuar në Rahoveci, niseni me pastrimin e Zhdrellës.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryeuses! I nderuar kryetar, kolegë, asambleistë, pjesëmarrës. Te pyetja e Defrim Kafexhiut në lidhje me punën e Drejtorisë së Urbanizmit. Për ta vlerësuar punën e një drejtorie, janë raportet e publikuara për çdo vit. Nëse ndalesh dhe e shikon, në vitin 2020 në Drejtorinë e Urbanizmit i kemi pasur 13 aplikime për leje mjedisore, 31 aplikime për leje ndërtimore dhe 68 aplikime për kushte ndërtimore dhe leje të rrënitimit nuk kemi pasur. Raporti i vitit 2023 thotë: 73 aplikime për leje ndërtimore, 120 aplikime për kushte ndërtimore, 32 aplikime për leje mjedisore dhe 9 aplikime për leje të rrënitimit. Drejtoria e Urbanizmit së bashkë me ekzekutivin kemi arritur ta përgatisim PZhK-në 2023 – 2031, ku përfshihet tërë territori i Komunës së Rahovecit. Ka përfunduar shqyrtimi publik për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale dhe në seancën e shkurtit ka me qenë në kuvend për marrje të pëlqimit. Po ashtu jemi duke e përgatitur edhe draftin për Hartë Zonale dhe nëse e vlerëson punën e drejtorisë duke mos u bazuar në raportet e vetëm 3 viteve të fundit nuk është mirë, sepse aty mund ta shihni dallimin e kërkesave 2020-2023. Sa i përket pyetjes së Drilon Mustafës për digjitalizim të drejtorisë, jemi duke punuar në atë drejtim, por derisa është ligji në fuqi që kërkon 3 kopje fizike për leje ndërtimore, nuk kemi mundësi për asgjë.

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përsëritet kryetar, përsëritet për të gjithë. Burim Krasniqi bëri pyetje rreth kontratës për vendndalime për stacion të autobusëve: Kontrata është lidhur me 12.10.2023, kodi i protokollit është 5731 dhe kontrata është 127.000€. Sipas specifikave në kontratë, janë rreth 20 vendndalime, 4 janë digjitale me monitor dhe janë për zonën urbane, ndërsa 16 të tjera janë për zonën rurale. Kryesisht, këto vendndalime do të vendosen në pjesë të rrugëve rajonale, për shkak se edhe autobusi po ndalet pikërisht në këto pjesë. Sëfajti pyeti rreth çështjes të larjeve të rrugëve në Krushë të Madhe. Po, Sefë, është e verëtetë që ne e kemi pasur në kontratë vetëm 1km, është përfunduar kontrata dhe tani e kemi kontratën e re ku janë shtuar edhe 3 km të tjera. Sivjet do të kujdesemi më shumë në mirëmbajtje, do të bëhet pastrimi në dy degëzime, nga ajo që fole ti dhe te rruga që përfundon prej udhëkryqit në drejtim të Rahovecit. Pyetja e kuvendarit Valmir: Po Valmir, është e vertetë që 4 ura i ka ndërtuar Drejtoria e Shërbimeve Publike në vitin e kaluar. Sidoqoftë, sa i përket pastrimi i atij kanali, shumë shpejt do të pastrohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, e cila e ka një kontratë për pastrimin e kanaleve.

Avni Morina: Përsëritet kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, vëzhgues të OSBE-së. Do t'i përgjigjem shkurt asambleistit Bejtullah Deliu për çështjen e pikave që i takojnë kontratës kolektive. E para e punës, duhet ta dijmë që nga nëntori 2022 Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave janë tërhequr nga kontrata kolektive dhe nga ajo periudhë nuk ka marrur përsipër që të shlyej asnjë borxh që i përket obligimeve të kontratës kolektive. E dyta, përgjegjësia për vërtetimet e përvojës së punës dhe për numrin e ditëve të punës është individuale. Në çoftëse një drejtor shkolle ka bërë gabim, atëherë ai duhet ta dij që një vit mësimor i ka 185 ditë mësimi dhe nëse ai i ka bërë 200 ditë, do të jep përgjegjësi ai, ose zyrtari i DKA-së që e ka lëshuar atë vërtetim. Prandaj është mirë që të verifikohen këto, sepse pagesat për shujta bëhen duke u bazuar në numrin e ditëve të punës.

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë, asambleistë. E pata një pyetje nga asambleisti z. Mustafa. Projekti nuk ka ndryshuar asgjë. Te pjesëmarrja e kolegëve asambleistë në përrurim, të them të drejtën nuk e di pse nuk kanë marrur pjesë, njoftimi ka qenë publik. Shpresoj që në gurëthemet tjera të marrin pjesë të gjithë.

Saranda Sallteku: Përsëritet për të gjithë! Sa i përket pyetjes së Eqrem Spahiut rreth QMF-së në Opterushë, kemi qenë me inxhinierë disa here për vizitë dhe e kemi gjetur problemin se nga se po bëhet lagështia. Akoma kemi garancion 2 vjeçar dhe shumë shpejt do ta rregullojmë.

Burim Krasniqi: Drejtor, sa i përket kabinave (vendndaljet e autobusëve), ministria është përgjegjëse për rrugë rajonale dhe nacionale, nuk është komuna. Edhe pse kemi transport urbano-periferik që përshkon rrugët rajonale, ato i ndërton ministria. Ministria ka kontratë, fillimisht i ka ndërtuar hapësirat për ndaljen e autobusëve dhe tani kabinat. Konsideroj që është e rëndësishme që komuna ta zgjidhë këtë problem brenda qytetit, si dhe dhe në rrugët lokale. A është gërrshëm i projektit apo ndonjë dakordim me ministrinë? Sepse nuk ka logjikë që komuna me atë buxhet të vogël që e ka, të ndërtojë vendndalje të autobusëve nëpër rrugë rajonale. Nuk është kompetencë e komunës, është e ministrisë.

Hasan Përboqi: Faleminderit! E kam një pyetje për kryesuesin, por para se t'ia bëj pyetjen, fillimisht e përgëzoj kolegen Dafinë për dhuratën, do të ishte mirë të vazhdojë edhe unë sepse është fillimviti dhe duhet të ofrojmë dashuri. Një dhuratë për kryesuesit do të ishte që Statutin dhe Rregulloren e Kuvendit ta lexojë sa më shumë sepse i duhet. Pasi që ia ndërpreve fjalën Hasanit, e keni parë edhe vet se sa është zbatuar rregullorja dhe sa ka pasur diskutime nga kolegët (kolegën kanë bërë mire, sepse pika është për diskutime dhe janë të votuar për të diskutuar këtu). Pyetja është se sa e keni zbatuar rregulloren pas asaj që ia ndale fjalën Hasanit dhe Lirigzonit? Këtë dhuratë mos e harro se të duhet. Jam shumë skeptik nëse e keni lexuar rregulloren, sepse në asnjë nen në rregullore nuk e përmend decimitivsh t'ia ndërpreni fjalën Hasan Përboqit, sepse më pas diskutime të shumta ka pasur. I keni në regjistrim të kamerave të gjitha dhe e vërtetoni a kanë dominuar diskutimet apo pyetjet. Nëse e keni diçka personalisht me Hasanin, Hasani këtu është, 29 vjet i kam bërë dhe kurrë në jetën time nuk iu jam nënshtruar askujt, e jo ty. Tregoje rolin e kryesuesit. Mos u bë viktimë dhe digitoron i televizorit i të tjerëve.

Kryetari: E lus Hasanin! Këtu nuk është para nxënësve dhe personale nuk ka asgjë. Hasan Përboqi, pije pak ujë të ftohtë dhe mos i personalizo gjërat. E lus gjithashtu kryesuesit! Rregullorja duhet të zbatohet dhe tjetër është që ju nuk po e zbatoni. Nuk është mirë të flasim vetëm për kryesuesin, sepse në të njëjtën situatë nuk ia kemi zbatuar rregulloren as ish kryesuesit. Kryesuesit i kërkoj që ta respektoj pikë për pikë rregulloren e kuvendit të komunës. Prandaj nuk ka personale asgjë këtu. Të lutem, je mësimdhënës dhe shef i një grupi politik më të madh në Komunë të Rahovecit. Në seancë po ndodhin shumë komente dhe diskutime që realisht po dalim jashtë rendit të ditës. Nuk po them që kjo është e ndaluar, po më mirë është ta vendosim një pikë të re në rend dite si pikë të fundit dhe ju siguroj që ju do të lodheni duke diskutuar dhe do t'ju dalin punë të tjera, ndërsa unë do të jem këtu. Gjopa mandatore në mjedis janë gjithsej 41 gjopa (me vlerë 1350€) dhe janë pak në krahasim me ato që po aspirojmë. Ne e kemi vetëm një inspektor të mjedisit (Metush Isma) dhe inspektori duhet të ketë bashkëpunim me qytetarë, me asambleistë, me kryetarë të lagjeve dhe me policinë, sepse edhe policia ka të drejtë ekskluzive të shqiptojë gjopë mandatorë për mjedis. Procesi i vetëdijesimit dhe i ndërgjegjësimit të qytetarëve është proces i ngadalshëm, megjithatë është duke ndodhur. Kemi fushata për mbrojtje të mjedisit dhe gjithashtu veprime institucionale. Qëllimi ynë është që sa më pak të kemi probleme rreth hudhjes së mbeturinave vend e pavend. Ju ftoj të gjithëve për bashkëpunim në ruajtjen e mjedisit. Sa i përket dënimeve, sistemi është i konsoliduar deri në atë pikë sa nuk mund t'i ikin, dënimi nuk parashkruhet dhe nëse nuk paguhet në afate të caktuara, shkon deri te përmbaruesi. Te Lirigzon Kastrati: Nuk është në rend dite, ishte në rend dite në seancën e dhjetorit Raporti i Kryetarit dhe Ekzekutivit dhe i ngrite disa çështje që nuk janë sot. Në programin qeverisës është kryetari i komunës ai që i ka fituar zgjedhjet, i cili e ka një program qeverisës dhe rrjedhimisht edhe plane vjetore të punës së tij. Në plan të punës, ka prioritet, qëllime dhe zotime. Njëri nga zotimet ka qenë edhe ky për lindje. Sa i përket përmbushjes së premtimeve, e dini që jemi komuna e parë në shkallë republike që 39 premtime i kemi të përmbushura plotësisht deri në qershor 2023. Vetëm 11 premtime i kemi edhe të pa filluara. Dilemë kam vetëm për një premtim, për ligjin i cili e shpall Rahovecin me rrethinë Zonë Strategjike të Interesit për Bujqësi, sepse kjo nuk varet nga ne, për të tjerat, në fund të mandatit e shihni raportin e Institutit GAP. Pse përsëriten sinimet? Sepse janë premtime publike dhe synimet vazhdojnë, p.sh. Unë nuk kam hequr dorë nga Qeverisja e Hapur, është një synim që do të vazhdojë dhe është normale që përsëriten sepse synimet i kam të qarta. Kemi edhe premtime që nuk lidhen vetëm me ne, por edhe me nivel qëndror. Premtimi për kolektorin e madh të ujërave të zeza, te impianti i ujërave të zeza, kemi thënë që ne do të angazhohemi, por nuk kemi thënë që ne do ta bëjmë sepse është projekt i madh që bëhet me qeveri e donatorë. Projekti kushton mbi 40 milion. Ju lutem që të jemi konkret dhe për zbatimin e programit qeverisës është qytetari që në fund vendosë dhe unë iu jap llogari qytetarëve. Te granti i performancës me

9 shkurt, titullin do të ma dorëzojë kryeministri, kryeministër, të cilin nëse kisha pasur mundësi do ta rrëzoja dje dhe jo sot, sepse isha bërë vetë kryeministër dhe mendoj që jam më i zoti se ai.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Faleminderit kryetarit për përgjigje. Unë e di që projektet kryesore nuk keni arritur t'i përfundoni, sidomos të çështja e koloktorit të kanalizimeve dhe të shtrati i lumit. Këto janë projekte të cilat kanë dështuar dhe nuk janë përfunduar. Përkundrazi, të çështja e shtratit të lumit, qytetarët veçse dëme kanë pësuar. Dheu i ka bllokuar arat e tyre dhe ka pamundësuar punën. Disa qytetarë i kam ndaluar, pasi që kanë dashur t'i inicojnë padi komunës, për pengim të posedimit të pronës. Pyetja ime kryesore ka qenë që premtimet, sidomos të Sherbimet Publike dhe të Drejtoria e Bujqësisë për kontratat e dështuara, sidomos të rrugëve fushore që ka pasur kërkesa të shumta dhe nuk janë përmbushur. Kjo ka qenë çështja kryesore, për çështjet tjera kapitale me rëndësi e di që kryetari nuk mund t'i përmbushë dhe ka ngecje.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Të nderuar drejtorë të drejtorive, i nderuar kryetar, anëtarë të kuvendit, monitorues të organizatave – KFOR-it, qytetarë. Fillimisht është një gabim që e ka bërë, është Kazakistan dhe nuk e di pse më ka dalë prej mendjes. Kryetari dhe ekzekutivi po mundohen t'i japin një konotacion tjetër. Unë ju bëj thirrje që të kapeni më shumë të domethënien e diskutimit dhe sigurisht që e kam pasur për të keq, gjithashtu besoj që Drejtoria e Urbanizmit nuk është duke funksionuar në formën si duhet. Përndryshe, drejtori i dha arsyetimet. Drejtorin e vlerësoj të puna dhe kontributi rreth hartimit të PZhK-së. Drejtor, e keni nënshkruar një vendim të paligjshëm. Vendimi është i paligjshëm në refuzimin e një kërkesë për leje ndërtimore. Në momentin që ministria të ka treguar që vendimi i nënshkruar është i paligjshëm, e keni shfuqizuar dhe e keni nënshkruar një vendim tjetër që nuk dihet nëse është i ligjshëm. Unë e di që jurist nuk je, por, nëse vendimet po i bën zyra ligjore, atëherë dikush duhet me mbajtë këtë përgjegjësi. Ju e keni nënshkruar këtë vendim. Është një vendim prej punës së zyrtarëve që punojnë aty. Ky është problemi të cilin unë po e shfaq. Të që nga kjo drejtori janë dhënë 73 leje. Kam qejf t'i publikosh këto dhe të shohim se sa prej atyre lejeve i ka marrë vetëm një kompani projektuese (unë besoj që janë më shumë se 50%), e cila ka lidhje me zyrtarë të Drejtorisë së Urbanizmit dhe drejtoria në fjalë po del të jetë si një institucion privat, jo drejtori publike. Zyrtarët që lëshojnë leje ndërtimore me standarde të dyfishta, po i bëjnë dëm komunës sepse këtë e ka dëshmuar edhe Ministria e Planifikimit Hapësinor, kur e ka dhënë arsyetimin mbi vendimet për të cilat, palët kanë bërë ankesë atje. Palët tjera po penalizohen, po u kërkohej edhe dokumenta shtesë dhe në fundi nuk u japin leje fare, sepse zyrtarët janë tendenciozë që punojnë me standarde të dyfishta. Prej këtyre 73 lejeve ndërtimore, sa pranime teknike janë bërë? Ka ndërtime të cilat kanë leje prej Drejtorisë së Urbanizmit, gjithashtu e kanë prekur pronën publike. Për të gjitha këto, e pyes kryetarin se çfarë veprime është duke marrur (masë disiplinore) kundrejt këtyre zyrtarëve, sepse kryetari është i vetëdijshëm për këtë.

Albnor Mullabazi: Sa i përket kërkesave për leje ndërtimore, në vitin 2023 kanë qenë 74 kërkesa, prej këtyre është refuzuar vetëm një. Të rasti që e përmende: Në komunë të Rahovecit ajo nuk ka qenë zonë ndërtimore. Arkitektët që i kemi asambleistë e dinë që nëse komuna nuk e ka një hartë zonale, atëherë veprohet në rreze prej 50m. E kemi refuzuar për arsye se ka qenë jashtë rrezes prej 50m. Ministria është organ më i lartë se ne. Të njëjtin vendim që e kam marr, e kam shfuqizuar dhe e kam marr vendimin e ministrisë. Nëse e kemi rastin që ministria na lejon, ne mund të shkojmë edhe në ndërtime të larta. Nëse zyrtari i ministrisë është i gatshëm të merr përgjegjësi mbi vete, atëherë unë jam përsëri i gatshëm ta lëshoj vendimin e zyrtarit të ministrisë. Ne e kemi me rreze 50m, nëse ka ndërtim P+1 ose P+2, këto mund t'i lëshojmë. Nuk mund të lëshojmë P+4 dhe kjo ka qenë arsyeja që e kemi refuzuar.

3. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02343-0 me pronën e institucionit qendror, P-01422-5, zona kadastrale - Rahovec;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Sipas legjislacionit në fuqi, bëhet fjalë për një propozim vendim për marrjen e pëlqimit për këmbim e pronës në zonën kadastrale në Rahovec, konkretisht për një parcelë e cila gjendet para parcelave ku është duke u ndërtuar Sheshi Qëndor i qytetit. Është pronë e Agjencionit të Ujërave. Bëhet fjalë prej 132m² t'ia marrim atyre dhe t'i japim pronë komunale në sipërfaqe të njëjtë, e cila gjendet në zonë kadastrale në Rahovec, P-1422-5, në rrugën Rahovec – Malishevë, te pompa "Teuta".

Ilir Pallqa: E kam një pyetje të thjeshtë! Pse të gjitha procedurat burokratike po ndodhin tani, pasi që punimet në shesh kanë filluar. Pse nuk kanë përfunduar në mandatin e dytë të kryetarit? Besoj që këto kanë mundur të përfundohet edhe atëherë, sepse me këto procedura po dalin çdo ditë edhe problematika të reja.

Afrim Oruqi: Edhe kjo parcelë dhe parcelat të tjera që janë pjesë e sheshit qëndror të qytetit, për arsye të ligjshmërisë, nëse ju kujtohet një parcelë private e kemi vendosur në kuvend 6 herë sepse ministria kompetence që bën vlerësimin e ligjshmërisë është vonuar dhe një kohë të gjatë ka qenë ashtu, në dy seancat e fundit po na replikon me kohë reale dhe 8 muaj nuk kemi pranuar fare. Këto kanë mbetur pezull dhe përsëri do t'i vendosim në kuvend edhe parcela të tjera derisa ta kompletojmë dhe t'i bëjmë bashkë të gjitha parcelat me një numër dhe me një sipërfaqe.

Ilir Pallqa: Drejtor, je i lirë, faleminderit për sqarimin. Nënkryetar, ju keni përvojë, prej 2010-ës jeni në ekzekutiv dhe e dini shumë mirë që këto procedura po zgjasin. Një projekt kaq të madh është dashur të niset me procedura prej 2017-ës. Kështu mendoj unë dhe nëse keni ndonjë plan në 2030, niseni tani që pararendësi ta ketë më të lehtë.

Kryesuesi: Faleminderit Ilir Pallqa! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash nga anëtarët e kuvendit, miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02280-1 me pronën e institucionit qëndror, P-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, sipas ligjeve në fuqi, kryetari i komunës ju propozon që të merrni pëlqim për këmbim e pronës komunale me pronën e institucionit qëndror (Agjencionit Pyjor të Kosovës). Bëhet fjalë për parcelën në dalje të Rahovecit në anën e djathtë (mbi rrugën e tranzitit). Sipërfaqja e këtij propozimi për këmbim është 3ha për interesa dhe nevoja të komunës dhe bizneseve të komunës. Agjencionit Pyjor t'ja japim në këmbim pronën e komunës me nr. 2240-1 e cila gjendet afër rrugës Rahovec – Drenoc, konkretisht afër deponisë legale të mbeturinave. Qëllimi i këtij këmbimi ka të bëjë me projektet zhvillimore të komunës dhe për vetëpunësim.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht nga anëtarët e kuvendit, miratohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, në Komunën e Rahovecit;

Saranda Sallteku: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit. Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ 01/2016 për procedurat e themelimit dhe organizimit të komiteteve konsultative, Statutit të Komunës, Vendimit të Komunës së Rahovecit të datës 31.07.2023 dhe shpalljes së konkursit të datës 04.12.2023 kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin e takimit lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Komisioni ka dalë nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit me datë 31.07.2023. Komisioni për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, me datë 15.01.2024 ka mbajtur takimin e tyre. Në takim, komisioni ka bërë hapjen e dosjeve dhe pas vlerësimit të dosjeve. Komisioni ka pasur detyrë që nga 6 aplikantë, të përzgjedhë 5 prej tyre. Pas shqyrtimit të dosjeve, komisioni në mënyrë unanime ka vendosur që këta 5 aplikues të jenë pjesë e komitetit: Atdhe Rama -master i financave, Elmedina Jaha – bachelor e psikologjisë, Samra Kërqagu - bachelor e psikologjisë, Altina Mezini – bachelor e punëve sociale dhe Selman Shtavica – udhëheqës i shoqatës “Handi-Kos” – Rahovec.

Kryesuesi: Faleminderit drejtroreshë! A kemi ndonjë diskutim? Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht nga anëtarët e kuvendit, miratohet pika e pestë.

6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZhK), 2023-2031;

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, asambleistë. Para jush e kemi vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal. Arsyeja që ka ardhur përsëri për rishqyrtim është neni 3 i cili ka qenë në vendimin e parë, e në këtë të dytin duhet të hiqet. Në neni 3 thuhet: Të gjitha planet do të mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale. Zyra Ligjore e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kërkuar që ky nen të hiqet nga vendimi, ndërsa ne, gjatë marrjes së pëlqimit për PZhK nga ministria e njejtë është cekur që me Plan Zhvillimor Komunal nuk mund të lëshojmë leje (kushte ndërtimore), sepse me planin aktual që e kemi nuk mund të lëshojmë leje deri në miratimin e Hartës Zonale. Kjo do të thotë që të gjitha planet që kanë qenë nuk janë në

kundërshtim me PZhK-në. Kërkesë e Departamentit Ligjor në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është që neni 3 të tërhiqet dhe duhet të vazhdojmë për miratim në kuvend komunal.

Defrim Kafexhiu: Përsëritet edhe një herë për të gjithë! E pata një pyetje për drejtorin: Tani që po largohet ky nen prej këtij vendimi, si do të rrjedhin procedurat deri te koha e miratimit të Hartës Zonale? Fjala është për kushte dhe për leje ndërtimore.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Pyetjes së Defrimit iu kam përgjigj edhe në KPF. Gjatë javës së kaluar kam qenë në takim në departamentin ligjor të ministrisë me zyrtarët që cilët kanë marrë vendimin. Te ata është që me Plan Zhvillimor mund të jepen lejet, ndërsa te departamentin i planifikimit që është brenda të njëjtës ministri thotë që me PZhK nuk mund të lëshohen lejet. Dy departamente brenda ministrisë janë me vendime të kundërta. Deri në miratimin e Hartës Zonale vazhdojmë ashtu siç kemi punuar deri tani, duke u bazuar në ligjin për ndërtim.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht nga anëtarët e kuvendit, miratohet pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi i plotësim - ndryshimi të vendimit 01 Nr.167/23, datës 27.12.2023;

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kryesues, asambleistë, drejtorë, të pranishmëm. Para vetes e keni miratimin e planit të punës të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Prej MAPL-së është kërkuar rishqyrtim i ligjshmërisë i këtij akti administrativ. Në preambulë është dashur të ceket ligji për fshatin Hoçë e Madhe, e kemi përmirësuar edhe këtë dhe kërkohet përsëri votimi i këtij vendimi.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A kemi ndonjë diskutim? Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht nga anëtarët e kuvendit, miratohet kjo pikë.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së kuvendit për vitin 2023;

Kryesuesi: Atëherë, përsëritet për të gjithë! I nderuar Kryetar z. Smajl Latifi, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para jush e keni raportin e punës së kuvendit për vitin 2023. Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin dymbëdhjetë - mujor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit përgjatë periudhës janar-dhjetor 2023. Të nderuar anëtarë, në mbledhjet e mbajtura të vitit 2023 i ka aprovuar 111 vendime, 1 statut, 1 rregullore, ka shqyrtuar 17 raporte dhe 10 informata. Bazuar në këtë, kuvendi i komunës së Rahovecit ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në periudhën janar – dhjetor 2023 ka mbajtur: 12 mbledhje të rregullta, 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 2 mbledhje solemne. Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve. Sa i përket qëllimit, përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Ky raport ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, karshi qytetarëve.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Raporti realisht pasqyron atë që ka ndodhur në asamblenë komunale për vitin kalendarik. Format i fotografisë në faqen e parë, ndoshta nuk është i duhuri, ka mundur të jetë një tjetër më për nder. Sëfajti nuk është, në momentin që nuk e kam mikun në fotografi kjo është e papranueshme. E dyta, në disa vende thuhet mbledhje, në disa të tjera seancë. Gjatë raportit është mirë të jetë vetëm një term. Mirë është që raporti ta ketë numrin e faqeve dhe te buxheti është fakt që është miratuar 19milion, por në fund buxheti ka qenë 20milion e 465mijë euro në total. D.m.th a është buxheti sa ka qenë në 2023, apo sa është miratuar në 2023. Janë disa detaje për t'u kompletuar raporti i organit më të lartë legjislativ komunal, pjesa tjetër është në rregull.

Arbër Zenuni: Faleminderit Burim Krasniqi! Vërejtje me vend dhe besoj që Sekretaria e Kuvendit do t'i bëjë përmirësimet e nevojshme.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! Materialin dje e kam lexuar, por nuk më ka ra në sy propozim vendimi për shkarkimin e kryesuesit dhe emërimi për kryesuesin e ri.

Kryesuesi: Janë të paraqitura të gjitha në tabelë.

Sejfullah Sejfullahu: E ka përmendur një ditë Defrimi, sot po e them unë. Vizitën studimore të paraparë në muajin gusht, ta organizoni pak më herët, para prillit.

9. Informatë rreth aktiviteteve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2023;

Kryetari: Faleminderit kryesues! Ju them që kuvendi duhet të punojë pak më shumë, sepse ka nevojë që planet të realizohen më mirë dhe jo vetëm një vizitë studimore, por më shumë. Ju e keni një material që është përgatitur nga Sekretaria e Kuvendit e cila është pjesë e KKSBS-së, Skenderi në këtë rast. Gjatë vitit 2023, në përputhje me planin vjetor të KKSBS-së, i kemi mbajtur 6+1 mbledhje. Gjashtë është numri që kërkohet, por ne e kemi mbajtur edhe një më shumë. I kemi emrat e anëtarëve të KKSBS-së që janë votuar në kuvend, me automatizëm dhe përmes thirrjes publike. Gjatë vitit 2023, KKSBS-ja e ka zbatuar planin e vet dhe asnjë pikë e rendit të ditës nuk ka dështuar. Dy pika janë futur si standard i ri: Çështja e trajtimit të lumenjve dhe kontrolli i produkteve ushqimore. Ka pasur pika që përveç sigurisë së përgjithshme e prekin edhe sigurinë në shkollë, në trafik, marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme etj...Nesër e kemi mbledhjen e parë të KKSBS-së me planin e ri të punës. Fotografia ime këtu është pa ngjyra dhe e lus Sekretarinë që së paku vendosni ngjyrat, ose t'ju them të drejtën, fotografinë nuk ka pasur nevojë fare ta vendosni. Skenderi e di që më don dhe e dua, por, Skender, fotografi më nuk dua sepse dihet kush është kryesuesi i KKSBS-së. Sëfajthashtu pas promovimit të librit të tij, që e krahasojnë me figura të rëndësishme të skenës letrare, nuk ka nevojë për fotografi as me ngjyra, as pa ngjyra. KKSBS është organ shumë i rëndësishëm, i paraparë me ligj dhe që trajton temat e sigurisë publike. Për seriozitetin e këshillit dëshmojnë edhe akterët që janë pjesë, është komandanti i policisë, përfaqësuesit e komuniteteve fetare, të sektorit të zhvillimit ekonomik, përfaqësues të shoqërisë civile, të OSBE-së, FSK-ja. I falënderoj anëtarët e KKSBS-së për kontributin e tyre gjatë vitit 2023. Shpresoj për një nismë të mbarë në 2024. Ka ndodh edhe një ndryshim, në vitin 2023 si përfaqësues i bizneseve ka qenë Fadil Sylka, tani është Mustafë Korenica.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Temat që janë trajtuar janë tema që prekin direkt jetën e qytetarëve dhe përmirësojnë atë. Vitin e kaluar kemi pasur disa dikuri negative, sidomos tek vjedhjet dhe zjarrvëniet. A e keni ndonjë plan për këtë vit, t'i shpreshtoni kontrollat dhe njëkohësisht t'i mënjaroni këto raste, apo çfarë?

Kryetari: Fatbardhësisht, zjarre dhe plaqkitje ka pasur më pak në vitin që shkoi, sesa në të kaluarën. Kemi avancuar me kamera të sigurisë. Bashkëpunimi me policinë, duke kërkuar rritje të aktivitetit dhe njëkohësisht këto gjëra e zvogëlojnë shumë numrin e plaqkitjeve. Qytetarët gjithashtu kanë vendosur privatisht kamera në shtëpitë e tyre dhe i kanë futur në sigurime. Policia jonë ka arritur t'i zbardhë disa raste, të cilat janë kontribut i policisë së Kosovës. Masat për rritjen e stabilitetit të sigurisë përmes investimeve do të jenë subjekt i trajtimit edhe në KKSBS.

10. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar, janar – dhjetor 2023;

Afrim Limani: I nderuar kryesues! I nderuar nënkryetar, asambleistë, përfaqësues të KDI-së, LTM-së, medie. Për dallim prej raporteve të tjera periodite financiare (raporti 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor), ky raport final është gjithëpërfshirës me të dhëna dhe shënime të mëdha, në lidhje me të gjitha ngjarjet financiare që kanë ndodhur gjatë vitit fiskal 2023. Raporti gjithashtu përmban edhe kontratat e lidhura brenda vitit fiskal 2023. Në mënyrë të detajuar dhe analitike janë të paraqitura edhe obligimet financiare dhe kontraktuale. Të hyrat e rregullta (pa gjoba të gjykatave dhe të trafikut) në vitin 2023 në total janë: 1.790.000€, nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, atëherë, kemi një ndryshim pozitiv prej 533.444€. Në raport, në faqen 5, i keni prezantimin e të hyrave bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut, mirëpo pa 3-mujorin e katërt të vitit 2023. Ndërkohë, para dy dite ka ardhur edhe ky raport që ju nuk e keni. Atëherë, unë do t'ju prezantoj. Të hyrat prej 3-mujorin e katërt kanë qenë prej: 58.172€, që bashkë me të hyrat e rregullta dhe të hyrat e gjobave të gjykatave dhe të trafikut janë 2.052.288€. Nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, atëherë, kemi një ndryshim pozitiv prej 462.754€. Në këtë raport i kemi të prezentuara realizimet e të hyrave sipas kategorive ekonomike dhe disa shënime të tatimit në pronë. Në faqen nr.8 e kemi raportin e shpenzimit të buxhetit sipas programeve, duke përfshirë këtu edhe fondet burimore. Në total, shpenzimi i buxhetit është prej 20.386.000€. Në faqen 9 është një tabelë ku e kemi bërë prezentimin e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, që në % është 99.61%. Në këtë tabelar e kemi të prezentuar buxhetin sipas asaj që e kemi votuar në shtator, buxhetin fillestar dhe buxhetin final. Te prezentuara i kemi edhe obligimet financiare, në mallra - shërbime, dhe investime kapitale. Në fund, obligimet financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e ardhshëm janë: Kategoria mallra dhe shërbime 512.000€, investime kapitale 441.000€ dhe gjithsej bëjnë 953.000€. Viti 2023 është karakterizuar një ndër vitet më të suksesshme. Me transparencë buxhetore,

në nivel vendi kemi dalur komuna e parë. Raporti i Auditorit ka qenë me opinion të pakualifikuar, kemi pasur rritje të të hyrave dhe shpenzimi i buxhetit në një masë të madhe.

Defrim Kafexhiu: Raportin financiar e kam shfletuar. Nuk kam hasur në asnjë tabelar për çështjen e subvencioneve në Drejtori të Arsimit. Te kjo çështje po e bëj një pyetje drejtuar nënkryetarit, meqenëse drejtori i arsimit nuk është këtu. Nëse ka mundësi që për seancën tjetër, ose me një përgjigje me shkrim, sepse në seancën tjetër dua ta bëj një propozim. Sa ka qenë vlera e subvencioneve që është ndarë prej Drejtorisë së Arsimit për bursat e studentëve dhe nxënësve të shkollave dhe kur do të fillojë ndarja e bursave për këtë vit?

Burim Krasniqi: Faleminderit kryeuses! E dëgjova drejtorin, raportin e kemi pasur faktikisht në email. Drejtor, fillimisht raporti i auditorit është për vitin 2022 dhe jo 2023. Raporti i auditorit ka dalur i pamodifikuar për vitin 2022, për 2023 do ta shohim në qershor. Te të hyrat, është fakt që kemi rritje të të hyrave në krahasimin me vitin paraprak, por, besoj këtë e kemi si rezultat i rritjes së bazës tatimore të tatimit në pronë, apo si rezultat i kujt? Kur e shikojmë tabelën 2.2 faqe 7, numrin e faturave e kemi përafërsisht të njëjtë 2022 dhe 2023, ndërsa te të hyrat nga tatimi në pronë kemi rritje rreth 600.000€. Unë jam inxhinier, nuk jam ekonomist dhe te shpenzimet nuk e kam të qartë. I kemi tri tabela, A,B,C. Janë kode të ndryshme buxhetore, por përshkrime të njëjta në të tri tabelat. Faqe 10, 11, 12, nëse i shohim, e vërejmë që ka përsëritje. P.sh në tabelën A, shpenzimet postare, kodi 13330. Në tabelën B, përsëri kodi 13330. Në tabelën C, përsëri kodi 13330. Pse po ndodh kjo? Nuk jam shumë i familjarizuar dhe më intereson një informatë më e plotë rreth këtyre çështjeve. Sa i përket kodit mallra dhe shërbime, te shpenzimet i kemi disa kode (te tabela 3.4): Shërbime shtypje 21, shërbime kontraktuese tjera 21, shpenzime për anëtarësim 21, shërbime të varrimit 21, ngrohje qendrore 21, naftë për ngrohje qendrore 22 etj... A nënkupton që janë borxhe, ose obligime të bartura 2021, 2022, 2023, sepse janë të njëjta vetëm që e kanë edhe nga një përshkrim që thotë që janë 2021, 2022. Te çështja e shërbimit të përfaqësimit të avokaturës, prej 37.971.82€ sa i kemi pasur në 2022, tani në 2023 i kemi 45.785.15€ dhe kemi rritje prej 7-8.000€. Duke marrur parasysh që kemi rritje të shpenzimeve të avokaturës, a kemi rënie të realizimit të kërkesave përmes procedurave përmbartimore? Sepse duhet me qenë në proporcion, kur avokati paguhet më shumë, i bie që ka bërë më shumë punë, që në anën tjetër besoj që ka më pak dëm të shkaktuar për komunën sa i përket proceseve gjyqësore. Nëse shkojmë te kontratat te kontratat në 4.1, në përjashtim të 5 kontratave (blerja e dy autoambulancave, furnizim me karriga stomatologjike, kyçja në rrjetin elektrik për shtëpine e të moshuarve dhe furnizimi me centrifugë në laborator, furnizimi me vakcina për bagëti) që janë paguar paratë, pjesa tjetër, të gjitha kontratat janë të bartura në vitin tjetër dhe janë të papërfunduara financiarisht. E kemi rastin: Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-së, Lot 1, 2, 3, 4 janë kontrata në vlerë: 9000, 6000, 39.000, 13.000 dhe të gjitha janë të papaguara, borxhe të bartura në 2024. A nuk kemi pasur fare furnizim? Apo është vetëm kontratë? Apo ka pasur furnizim, po nuk ka pasur mjete dhe faktikisht është bartur si obligim nga 2023 në 2024. Në fund, te kontratat në 2023 e kanë vlerën 12.212.847.01€, janë paguar 1.671.401.66€ dhe 10.561.374.35€ Komuna e Rahovecit ka hyrë në obligime brenda vitit 2023. A është ambicie, keqplanifikim apo keqmenaxhim, këtë e thuani ju më së miri. Në tabelat e shpenzimeve, mungojnë shpenzimet rreth vendimeve të gjykatave. Mund të thuash që ka të përshkruara, por sipas tabelarëve A, B dhe C, komplet shpenzimet e gjykatave janë rreth 17.640€. A ka vendime përmbartimore? Sa para ia ka marrë përmbartuesi Komunës së Rahovecit? Këto nuk figurojnë te shpenzimet, ose figurojnë me ndonjë kod tjetër buxhetor. Drejtor, sa i përket obligimeve tjera, në 2023 sipas tabelës, furnizimi që keni blerë dru janë borxh (kodi 623). Te shpenzimet kapitale (te borxhet), i kemi 441.115€ sipas asaj që e keni prezentuar, por, kemi edhe fatura prej 2021, 2022 e deri 2019 që keni obligime të papaguara. Me këto borxhe financiare, a ka rrezik të shkuarjes në procedurë përmbartimore prej kompanive ekzekutuese të punimeve? Ajo që dua të ndërlihem, te kontratat (obligimet kontraktuale) duke filluar prej 2019 që kanë mbetur edhe 20.722€, në 2020 janë 979.000€, në 2021 janë 4.529.000€, në 2022 janë 5.948.924€ dhe në 2023 janë 12,886.105€. Si përfundim, Komuna e Rahovecit ka mbyllur vitin 2023 me 23.934.309.89€ obligime kontraktuale. Në seancën e fundit kur kemi diskutuar për planin e prokurimit dhe kam shprehur shqetësimet e mia, në përgjigjen e kryetarit ka thënë që Komuna e Rahovecit i ka 200.000€ obligime financiare. Kur të flasim me shifra duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Raporti Financiar e tregon të kundërtën. Lexoni procesverbalin e mbledhjes së kaluar, faqe 16. Realisht Komuna e Rahovecit ka 957.753.44€ borxhe apo fatura në pritje dhe jo 200.000€ siç është thënë në seancën e kaluar të 27 dhjetorit. Atëherë, në bazë të kësaj që unë e thash,

duke pasur parasysh borxhet 953.735€, obligimet kontraktuale prej 23.934.309.89€ dhe duke pasur parasysh planifikimin buxhetor për investime kapitale, mallra dhe shërbime që është prej 7.028.200€, kjo nënkupton që në fund të vitit 2024 Komuna e Rahovecit mbetet komplet me rreth 31.916.000€ obligime. Edhe me Grantin e Performancës dhe me të gjitha të tjerat nuk arrin ta zbutë obligimin kontraktual dhe financiar që e ka. Kështu, ajo që shihet qartë që komuna në rastin më të mirë përsëri do të jetë në obligime kontraktuale mbi 23 milion €. Kjo për mua është keqplanifikim, keqmenaxhim, ose diçka që e qon komunën drejt jostabilitetit financiar ndër vite. Ndoshta do të vij një momentum ku edhe kompanitë ndërtimore do të lodhen dhe do të kemi shumë çështje të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore. Mund të kemi procedura gjyqësore dhe përmbarimore edhe prej bizneseve. Edhe në qoftëse nuk pranohet faktura, nuk pranohet pozicioni, por ka plot projekte këtu që figurojnë si obligime kontraktuale dhe nëse dalim në terren ato janë të realizuara si objekte. Vetëm që komuna nuk e ka bërë pranimin teknik, ose nuk e ka pranuar situacionin e fundit për ta lënë si obligim kontraktual dhe mos të kthehet në obligim financiar, e realisht në terren është objekti i përfunduar. Kur të doni e bëjmë një komision të asamblesë dhe të dalim t'i shohim projektet që figurojnë si obligime kontraktuale, realisht janë objekte të përfunduara dhe nënkupton që janë obligime financiare. Në fund, kërkoj mirëkuptim nga drejtori që në seancën e radhës në email të na dërgoni pjesën e mjeteve që i ka marrë përmbaruesi (te kontratat kolektive dhe të faturat e papaguara), sepse nuk e pashë te vendimet e gjykatës, ose tregona në cilën tabelë figurojnë shënimet rreth mjeteve të tërhequra nga vendimet gjyqësore.

Hasan Përboqi: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Drejtor, më lejo të të falënderoj për këtë raport kaq të mirë, kaq detajist në të hyrat, ashtu edhe tek shpenzimet. Këtë jo që po e them vetëm unë, por e kanë thënë në mandatin e kaluar edhe asambleistët më me përvojë të partive tjera. Raportet e tilla kur paraqiten detajet kaq të mira, janë për t'u përgëzuar. Kjo tregon që, nuk jemi kot komuna më transparente. Po ndalem fillimisht në atë që unë në çdo mbledhje të janarit e konsideroj si shtyllë të buxhetit të komunës. Realizimi i të hyrave në atë që kemi arritur ta planifikojmë dhe realisht a kemi mundur ta realizojmë. Në një tabelar në këtë raport thotë që ka tejkalim të realizimit të të hyrave dhe d.m.th 123% ka realizim të të hyrave që janë të planifikuar në buxhetin e vitit paraprak. Kjo tregon që ka punë, kur ka punë ka seriozitet dhe rezultate. Për këtë gjendje duhet t'i falënderojmë qytetarët e Komunës së Rahovecit, që realisht po qëndrojnë afër obligimeve që ata i kanë ndaj institucionit të Komunës së Rahovecit. Kur qytetarët i realizojnë këto obligime, më tutje kërkojnë edhe punë dhe punën besoj që e kanë marrë në fund të vitit. 99.61% realizimi i shpenzimit të buxhetit, tregon që ato para që qytetarët i kanë paguar (tatim, leje ndërtimore, të hyra të tjera), atyre u janë kthyer me vlerë gati 100%. Po ndalem te obligimet kontraktuale, te tabela e fundit: obligimet kontraktuale nga çdo kategori 23.9 milion. Pyetja ime konkrete është se a është ky borxh real? Për një periudhë 2-3 vjeçare, sa do të arrijmë ne si komunë t'i ulim këto borxhe? Duke u bazuar në projeksionet buxhetore që janë bërë gjatë vitit 2024 dhe të krijojmë hapësirë edhe për projekte të reja.

Lirigzon Kastrati: Faleminderi kryesues! Shefi i grupit z. Burim Krasniqi, e paraqiti vlerën e kontratave dhe shumën që është paguar rreth 1.6 milion, kurse detyrimet e mbetura janë 12 milion. Të gjitha kontratat e projekteve të listuara, sa projekte kanë filluar gjatë vitit 2023?

Afrim Limani: Faleminderit për pyetjet! Së pari po i përgjigjem Defrimit. Defrim, subvencionet për bursa ndahen nga zyra e kryetarit. Nuk jam 100% i saktë, por rreth 60.000€ janë ndarë këtë vit për subvencione për arsim. Burimi i ngriti disa pyetje, kam arritur t'i shkruaj, nëse më ik ndonjë, mund të bëjmë bisedë interaktive. E para, te rritja e të hyrave the që janë rritur për shkak të ngarkesës tatimore. Jo, nuk është e vërtetë, sepse kemi bërë lirim të ngarkesës tatimore këtë vit dhe së zbatuari fillon në 2024. E dyta, e përmende ngarkesën tatimore në vlerë të kontratave. Sektori i tatimit në pronë e ka bërë një veprim që palët mos të paguajnë dy herë shpenzimet postare. Supozojmë që unë jam biznesmen dhe i kam 2/3 shtëpi. Këtu kemi bërë unifikime në mënyrë që t'i kursejmë disa shpenzime postare. I përmende dhe disa shpenzime tek mallrat dhe shërbimet. Raporti, po ashtu është i detajuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve se ku janë shpenzuar ato. Do ta jap një përgjigje te obligimet kontraktuale dhe këtu ndërlikjen shumë pyetje të tjera, të cilat i bërë ti, Hasani dhe Lirigzoni. Në raport e keni një raport të detajuar të obligimeve kontraktuale dhe realisht edhe të obligimeve financiare, nga viti 2020 deri në 2023. Në kuadër të këtij raporti nuk kemi vetëm investime kapitale sepse kemi kontrata të lidhura edhe nga mallrat - shërbimet dhe subvencionet. E kam bërë një seleksionim: Kontratat për mallra dhe shërbime të cilat janë në vlerë prej 2.289.000€. Subvencione janë 290.447€

dhe kur i zblesim obligimet kontraktuale dhe financiare të mbetura, janë 23.934.000€. Kur e zblesim kategorinë mallra - shërbime dhe subvencione, atëherë vlera e këtyre obligimeve mbetet 21.354.000€. Një gjëne dimë sigurt, qendrën rinore e financon Ministria e Kulturës 2.5 milion dhe gjithashtu edhe këtë vlerë e kemi në kuadër të këtij raporti dhe nëse i zblesim këto 2.5 milion, atëherë obligimet kontraktuale mbesin 18.854.000€. Ne e kemi një buxhet të votuar nga ju në shtator të vitit 2023 si dhe projeksionet 2024-2025-2026. Vlera e këtij buxheti në këto projeksione është 19.540.000€ që matematikisht e mbulon vlerën e obligimeve kontraktuale dhe mbesin rreth 1 milion€. Mos ta harrojmë edhe një fakt, tani është e definuar që i kemi edhe 650.000€ mjete të cilat do të barten nga viti 2023 në 2024. Gjithashtu me 9 shkurt e presim një grant të performancës rreth 2 milion€. Nuk e kam qejf lavdatën, por në këtë kuptim, ne jemi shumë komod me investime kapitale. Ndërsa në kategorinë mallra - shërbime që me të vërtetë i kemi disa obligime (511.000€), mirëpo edhe për këto e kemi një plan dhe gjatë vitit 2024 do t'i menaxhojmë shumë mirë. Kryetari: Faleminderit kryesues! Më bëri përshtypje procesverbali, meqë e përmendi Burimi. Në faqen 16 është e saktë, i përmendi 200.000€, por nuk e keni lexuar fjalinë deri në fund "... dhe kjo nuk do të thotë që nuk bëhen të tjerat në janar". Pra, i kemi barazimet e fundvitit, faturat, operatorët etj... Në momentin kur e kam thënë këtë, e kam thënë në pajtueshmëri të plotë me drejtorin e financave. Deri me 15 janar dihet që nuk kemi pasur buxhet, e tek sot ka filluar alokimi i buxhetit. E di shumë mirë që sfida të mëdha janë obligimet kontraktuale. Nga 2011 deri në 2023 "krytë n'a kanë ça" me këto obligime financiare e kontraktuale, janë përdorur gjithashtu fjali që kinse bankrotohet komuna etj etj... Ne kemi ardhur këtu që të punojmë, sepse ata që vinë në komuna dhe në shtet, vinë për të punuar. Me këtë fakt, krijomë marrëdhënie me palë tjera (operatorët), që funksionojnë vetëm sipas ligjit. Por edhe nëse jemi anarkistë në koncept (që nuk jemi), nuk mund të përdorim praktika anarkiste sepse ekziston një logjikë e veprimit institucional. Ministria e Financave, auditorët e jashtëm dhe vetë sistemi nuk do ta lejonte një gjë të tillë, që krijon hendek që nuk mbyllet. Dëgjova që ndodhta nuk janë paguar drutë, mua më intereson të ketë nxemje. Për pagesë do ta gjejmë formulën nëse nuk janë paguar, i paguajmë. Praktikant me ZKA-në na kanë qartësuar që nuk duhet të bëjmë kontrata pa mbulueshmëri financiare dhe që nuk bën të nënshkruajmë kontrata pa zotim të mjeteve si dhe prandaj raporti për 2022 ka thënë që Komuna e Rahovecit ka shënuar progres të jashtëzakonshëm në zbatimin e rekomandimeve. Përkundër asaj që nuk kemi përkrahje të mjaftueshme nga qeveria, ne luftojmë për shumë grante dhe përfaqësojmë konceptin luftarak. Për gropa septike i kemi fituar 210.000€, jemi në levizje dhe dinamizëm, sepse i shohim gjërat në proces. Nuk jemi të gatshëm që "çmendurinë" në thonjza, ta bëjmë çmenduri reale dhe nuk jemi të gatshëm të bëjmë punë të kundërligjshme, sepse nuk jam i interesuar të shkoj as te hetuesi, as te prokurori. I kemi edhe ne shqetësimet tona, por besoj që jemi mirë. Kemi obligime sepse dikujt duhet t'i themi "t'i japim me rrush" e ia vonojmë, e dikush tjetër nuk po i kryen punët, nëse ndodh kjo, atëherë operatori nuk mund t'i merr paratë, përkundër asaj që është obligim kontraktual. Në kushtet e Kosovës dhe në kapacitetet që i ka komuna, duhet t'i hyjmë punëve me një besim të plotë. Nëse të kujtohet, në seancë pate thënë që "t'i kushtojmë kujdes borxheve". Vitin e kaluar kur i kemi diskutuar këto tema, kemi pasur borxhe edhe të vitit 2016, 2017 dhe tani kemi arritur te 2020-ta. Përsëri nuk jemi komod, por është një situatë e menaxhueshme. Shteti nuk i ka mbetë borxh askujt, as komuna jonë si mekanizëm i këtij shteti. Këtë nuk kam dashur ta them kurrë, sepse nuk na takon neve, por, me ligjin aktual të prokurimit dhe me ofertat që ia bën shteti operatorëve, me çmime kaq të lira, fatkeqësisht mos kërkon punime të cilësisë së lartë. Fatkeqësisht Kosova është në këtë fazë dhe fatkeqësisht nuk ka ende vullnet të mjaftueshëm nga qeveria dhe kuvendi për ndryshim të ligjit të prokurimit publik. Plot këtu e dinë se çka po flas. Kemi obligime kontraktuale, synojmë t'i realizojmë projektet dhe sa më pak obligime financiare të mbesin dhe t'i shmangim dërgimin te përmbartuesi, përkundër asaj që ata kanë të drejtë të shkojnë aty.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Te raporti financiar nuk kam hasur ta shoh ndonjë projekt që është bërë dhe parakish me ta këtë SWOT analizën. Dua të pyes, a është ndarë ndonjëherë ndonjë fond për ndonjë SWOT analizë për projektet përkatëse?

Kryetari: Keni të drejtë plotësisht! Secili projekt është dashur ta ketë një lloj fizibiliteti apo trajtimi dhe më pas t'i ketë efektet projekti. Në çoftëse shkojmë me standarde bashkëkohore dhe evropiane, në shumë vende bëhet

analiza. Ne, nuk kemi mundësi, sepse ndonjëherë nuk na premton edhe koha. Ka shumë procedura, fillimisht duhet të ketë fizibilitet (rreth 100.000€) edhe kjo rruga 4 korsi. Nuk e besoj që nëpër komuna të Kosovës ndodh kjo, veç me ndonjë projekt që lidhet me komisionin evropian (Cross Border dhe OJQ ndërkombëtare). Me këto analiza dhe ekspertiza tjera, obligimet financiare rriten ende më shumë. Shumë shpejt Kosova do të vie në këtë pikë të punës, sepse nuk ka rrugë tjetër dhe prandaj e thash që ligji i prokurimit ka nevojë për ndryshim.

Ilir Pallqa: Faleminderit kyesues! The që do të vij koha bashkëkohore! Për të ardhur ajo kohë, dikush duhet t'ia nisë. Niseni ju, me atë çështjen që e kemi diskutuar për liqen! Faleminderit.

Kryetari: Faleminderit! Këta kujtojnë që e dinë se çka kemi diskutuar. Po e bëj publike. Nga 2011-ta kemi kërkuar, kur Musa Cena ka qenë drejtor i Ekonomisë dhe gjithashtu ka qenë bartës i hartimit të PZhK-së. Nga ekspertët është paraparë që mund të bëhet një pendë akumuluese në atë pjesë. E kemi futur në PZhK-në e re dhe i takon zonës së turizmit. Aty mund të zhvillohen aktivitetet që lidhen edhe me agro-turizëm dhe me eko-turizëm. Është një projekt ideor dhe e kemi diskutuar me Ilirin. Ajo pjesë është bukur e përshtatshme, sepse është atraktive dhe ka shumë burime. Jam për ta ndërtuar një pendë akumuluese. E kemi bërë kërkesën në Ministri të Bujqësisë, sepse zakonisht këto projekte financohen nga shteti për shkak që edhe burimet ujore janë nën menaxhim të tyre. Është e kushtueshme dhe zakonisht komuna mund të kontribuojë në lehtësira (aplikim për leje, pëlqime, ide dhe kontribute të tjera). Në momentin kur e pranojmë ligjshmërinë për PZhK-në, une jam i gatshëm të bëjë diçka serioze në atë pjesë, që i jep fuqi, zhvillim dhe përparësi komunë sonë si zonë e bukur. Përndryshe, me PZhK, me HZK dhe VSM do të jetë gjithçka në rregull.

Ilir Pallqa: Kryetar, kemi informatë që do të garoni për deputet! Pse s'po hyni në fushatë me këtë projekt? I shton disa vota.

Kryetari: LDK-ja, PDK-ja, kur shprehte dëshirë për ta larguar dikë nga këtu, i thoshte “do të qojmë lartë atje”. Më vie mirë që je në rrjedha, prej kur ia paskë filluar punën në shërbim informatic ti? I bie që paska zgjedhje sivjet!? Mirë shumë. Pë atë pjesë që folëm, është mirë të bëjmë diçka.

Burim Krasniqi: Kryetar, çështjen e Ilirit e marr pak me sportivitet, ju vetë keni thënë që “jam për politikë atje lart, e jo për këtu”. “Kam kapacitet”. Drejtor, je përgjigjur në disa pyetje, por në fillim je përgjigjur siç ke dashtë vetë dhe jo siç ta kam bërë pyetjen! Në tabelën A, B dhe C janë tri tabela të ndryshme, kodet janë të ndryshme, përshkrimi është i njejtë. Nëse e vëren një përshkrim në tabelë A, të përsëritet në tabelën B dhe C. Më intereson, pse ndodh kjo? E detyra, mirë që janë larë borxhet e hershme, sepse e di që prej 2016 ka pasur borxhe. Në raportin financiar të 2022, hyra për kurrëshjte dhe e shikova: Keni thënë që obligimet janë 17.5 milion€, tani janë 23milion, kjo d.m.th që nuk ka rënie të obligimeve, por ka rritje. Në çoftëse planifikohet buxheti në KAB për investime 19 milion, në 2024 janë 12 milion automatikisht kontrata që planifikoni t'i lidhni. Për tri vjet, mbesin edhe 7 milion dhe e them në atë kuptim që obligimi kontraktual nuk shkon duke u ulur. Këtë nuk po e them që ta dërgoj dikë në prokurori e as në gjykatë, por mua më intereson një ecje normale e Komunës së Rahovecit, ashtu siç ne e mendojmë dhe e vlerësojmë. E treta, janë obligime kontraktuale, por, realisht nëse e shikojmë projektet janë të përfunduara. Vetëm që nuk i keni pranuar fakturat, mirë që s'i keni lejuar, mirë që edhe ata ju kanë dëgjuar, përndryshe futet në obligim financiar (borxh). Një shembull: Vlera prej 297.874€ është furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerë, lot 1, 2, 4, 5. Kontratat e 2021 dhe mjetet bujqësore janë shpërndarë. Kontrata është realizuar, bujqit janë furnizuar. Obligimi këtu është edhe 297.874€. Në parim, ky është borxh financiar dhe kjo kontraktual, sepse puna ka përfunduar. Mirë që operatori nuk e bie faturën dhe e gjeni mirëkuptim mes vete dhe mbetet si obligim kontraktual. Realisht ka projekte të përfunduara në terren, por nuk është pranuar fatura dhe mbetet si obligim kontraktual dhe jo si obligim financiar. Rekomandoj që të shtohet kujdesi dhe në fund të fundit, aty nuk ka mjete financiare, t'i thoni që mos të punon, sepse nuk ka mjete financiare. Përndryshe, operatori nesër ta bën faturën, pasnesër ta dërgon te përmbartuesi. Nuk e them këtë që ta dërgoj dikë në përgjegjësi lidhore, sepse nuk është punë e imja, por është vetëm shqetësim i yni.

11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Performancës Komunale për vitin 2022;

Bjondina Ramaj: Përshëndetje për të gjithë! Raporti i Performancës 2022, rezultatet e komunës sipas fushave dhe treguesëve. Ne raportojmë për 19 fusha: Shërbimet publike administrative, transparenca komunale, përgjegjshmëria komunale, barazia në punësim, menaxhimi i fatkeqësive, planifikimi hapësinor, hapësirat publike, infrastruktura rrugore, transporti publik, parkingjet publike, uji i pijshëm, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave, mbrojtja e mjedisit, përfaqësimi gjinor, arsimit parauniversitar, kujdesi primar shëndetësor dhe zhvillimi ekonomik lokal. Vlerësimi i treguesëve është bërë në koordinim me zyrtarët komunalë dhe me drejtorët. Raportimi i të dhënave bëhet përmes sistemit elektronik të menaxhimit të performancës komunale. Ky sistem i ka zyrtarët raportues dhe koordinatorin. Në të ardhmen, ministria me donatorët janë duke punuar që çdo qytetar të ketë çasje. Të gjitha të dhënat që ne i raportojmë, t'i shohin edhe qytetarët. Për momentin të dhënat raportohen në mënyrë sasiore dhe cilësore, ka edhe disa të dhëna komulative. Te baza juridike, kemi një ligj që është për performancë komunale dhe udhëzimi administrativ dhe procedura dhe afate. Ne jemi një ndër komunat më të mira në nivel Kosove, përkundër kësaj kemi nevojë ende për punë tjera. Sa i përket vlerësimit të performancës komunale dhe grantit të performancës, ne jemi të parët. Këtu i kam edhe kushtet minimale sa i përket grantit: Komuna duhet të ketë raportuar sipas afatit, komuna duhet të ketë respektuar obligimet ligjore dhe aktet komunale të vlerësuar, opinionin vjetor i auditimit së paku i pamodifikuar, të shpenzohet së paku 75 % e buxhetit për investime kapitale. Këto janë kushtet minimale për të qenë pjesë e grantit.

Kryetari: Faleminderit Bjondinë! E falenderoj grupin punues. Bjondina është koordinatore për performancë. Kuptohet puna e përbashkët e kuvendit dhe e ekzekutivit, bashkëpunimi me qytetarë, transparenca dhe të gjitha veprimet e mira që ndodhin në komunën tonë, na bëjnë krenarë të gjithëve. Të jesh në nivel vendi, i pari edhe për performancë edhe për grant është shumë lajm i mirë.

Ilir Pallqa: E përgëzoj zonjën Bjondinë! Ky është raportimi më i mirë që e kam dëgjuar deri sot në kuvend.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje edhe një herë! Pajtohem me Ilirin dhe e përgëzoj ekzekutivin për punën e mirë që po e bën. Po dalim si komunë e parë dhe po e përfitojmë grantin e performancës që disa vite radhazi. Kjo është njëra prej veprimtarive që realisht ju përgëzojmë.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Me të vërtetë kanë thënë “Trimin vraje, hakin mos ja ha”. Ne jemi opozitë, por duhet t'i pranojmë sukseset, sepse janë për komunë tonë dhe për të mirën e qytetarëve tanë. E urojmë kryetarin dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për ta zënë vendin e parë në performancë. E falenderoj posaçërisht koordinatoren Bjondina Ramaj Fazliu, suksese tutje.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Mos të mbes vetëm unë pa lavdata për kryetarin. Gjatë fjalimit të kryetarit më mbeti enigmë ajo puna “tri zallë, një cement”.

12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë, në mungesë të kryesuesit Bajram Morina, ju prezantoj raportin që e keni përballë. Ky raport ka të bëjë me një pasqyrim të aktiviteteve dhe angazhimeve të Komitetit për Komunitete, janar - dhjetor 2023. Fokusi kryesor i këtij komiteti është në përmirësimin e situatës të komunitetit joshumicë, fuqizimin e pozitës së tyre fushën e arsimit dhe promovimin e vlerave të diversitetit etnik, riatdhesimit dhe kthimit të qëndrueshëm etj... Nëse keni ndonjë diskutim apo pyetje, përgjigjet mund t'i pranoni edhe me email.

13. Shqyrtimi i informatës mbi realizimin e Planit të Veprimit për Transparençë Komunale 2023;

Blerta Gashi: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, monitorues, medie dhe ju të pranishëm. Sot para jush do të paraqes një informatë mbi planin e veprimit për transparençë komunale 2023. Është etike të ceket që përgjatë gjithë vitit unë kam qenë në pushim të lehonisë, andaj do ta paraqes punën të cilën e kanë bërë zyrtarët e tjerë dhe e kanë mbajtur në mënyrën më të mirë, zyrën e informimit për vitin 2023. Me 30 janar 2023, në seancë të rregullt të kuvendit komunal, është marrë vendimi për miratimin e planit të veprimit për transparençë komunale 2023-2027. Në këtë raport janë të përfshira të gjitha aktivitetet me impakt publikë e zyrtarë që janë realizuar gjatë vitit 2023. Publikim i aktiviteteve komunale për këtë vit e kanë kryer zyrtarët e IT-së, Dritan Sokoli, respektivisht Petrit Haxhijaha. Këtë vit do të vazhdojmë me praktikën siç e kemi pasur deri tani. Duhet cekur me patjetër që ueb-faqja zyrtare ka pasur probleme të mëdha, duke na

shkaktuar probleme të publikimit në kohë, kur dihet që ka afate ligjore që duhet të respektohen, sepse mbi këtë bazë monitorohemi. Gjithashtu janë fshirë shumë dokumente me rëndësi, për të cilat nuk jep përgjigje askush, komuna po ashtu nuk e ka të drejtën e rikthimit të atyre dokumenteve. Plani i veprimit për transparencë komunale përfshin: Publikimin e thirrjeve dhe njoftimeve për mbledhjet e rregullta të kuvendit dhe të komiteteve. Gjatë gjithë vitit 2023 me kohë janë publikuar njoftimet dhe materialet përcjellëse për mbledhjet e rregullta, të jashtëzakonshme dhe mbledhjet solemne. Janë mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, 2 mbledhje solemne, 3 të jashtëzakonshme dhe 1 komemorative. Të përcaktuara me ligj, kryetari i komunës i ka dy takime publike të cilat i ka mbajtur, po ashtu janë mbajtur edhe takime publike nëpër fshatra dhe lagje të qytetit, gjithsej 8 takime. Gjatë vitit 2023 janë mbajtur 11 dëgjime buxhetore. Gjatë vitit 2023 janë dhënë shumë intervista për televizione nacionale, kemi mbajtur komunikime zyrtare me portale të ndryshme dhe u jemi përgjigjur gazetarëve, qytetarëve dhe organizatave joqeveritare. Me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ për administratë të hapur në dhjetor të këtij viti, nga MAPL-ja, sipas nenit 44 pika 1 obligohemi që këtë vit të hartojmë rregulloren e re për transparencë, si dhe planin e veprimit për transparencë.

Kryetari: Faleminderit Blerta Nalli dhe gjithë ekipin për këtë përkushtim dhe vëmendje të jashtëzakonshme. Në çoftëse në performancë kemi dalur ndonjëherë të parët, ndonjëherë në vend të dytë e të tretë, në transparencë nga 2018 vazhdojmë të jemi të parët. Kryetari i Drenasit, e ka publikuar aty kinse janë të parët, por edhe ne i kemi 100 pikë dhe nuk kemi faj që Rahoveci fillon me R, e Drenasi me D.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Komunal të fshatit Hoçë e Madhe;

Kryesuesi: Në mungesë të anëtarëve të këshillit, pasi që kanë qenë të ftuar nga koordinatori Senad Mullaavda, i cili ka punuar së bashku me ata. Raportin e keni para jush dhe mund të parashtroni komente.

Burim Krasniqi: E kemi diskutuar edhe në seancën paraprake. Me gjithë respektin për secilin, kjo është e papranueshme. Duhet të jetë prezent dikush prej anëtarëve të këshillit, jo Senadi, që është pjesë e administratës, por dikush prej anëtarëve, sepse në fund paguhet për këtë punë. Të kërkoj mirëkuptim, që si kryesues i kuvendit t'i thirrni në një takim dhe t'i thoni që ata duhet të jenë në bashkëpunim me kuvendin e Komunës së Rahovecit, pavarësisht bindjeve prej nga vijnë. Nuk jemi duke i gjykuar, a ka punuar apo jo, por raportimin e kanë obligim. Është ofendim ndaj një organi që të ka zgjedhur, kur ti nuk shkon t'i raportosh organit të njejtë.

Kryetari: Po Burim, çështjen e keni ngritë edhe herën e kaluar. Jam dakord, sepse ata i japin llogari kuvendit të komunës. Kuvendi edhe i zgjedh edhe i shkarkon. Ndjeshmëria e situatës politike në Kosovë është e atij niveli që prodhon efekte edhe në nivel lokal. Do të ishte mirë që kuvendi t'i ftojë në takim vetëm ata dhe të tragojnë edhe për punën e tyre.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Burim, këtë vërejtje do ta kemi parasysh.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Lokal për Biodiversitet;

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Të nderuar asambleistë, para jush keni vendimin për planin për biodiversitet. Arsyeja pse është kthyer prej ministrisë është miratuar në fund të vitit dhe sipas tyre viti 2023 nuk numrohet si vit dhe është kërkuar t'i ndërrojmë vitet 2024-2029. Për të njejtën arsye është rikthyer edhe **Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit**.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë vazhdojmë me pikë e parë për biodiversitet. Kush është “për”?... Kundër?... Unanimisht votohet për miratimin e planit lokal për biodiversitet. Pika e dytë: Vendimi për planin lokal për cilësi të ajrit, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet edhe pika e fundit. Të nderuar anëtarë, me leje ju kërkoj që prej mbledhjes së ardhshme ata që do të jenë prezent nga fillimi e deri në fund, do të jenë në listë me nënshkrime për mëditje, gjithashtu ju kërkoj çasje më korrekte ndaj kuvendit.

Procesmbajtësi:

K R Y E S U E S I

Albion Krasniqi

Arbër Zenuni

Kërkesat për për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale

Nr	Parashtresi i kërkesës	Vendbanimi	Propozimi	Ndarja	Column1
1	Ali Veseli	Celinë	Ali Kabashi	Segment nga rr. "Rifat Dina"	Celinë
2	Gazmen Osa	Rahovec	Arben Osa	Segment nga rr. "Ali Hasku"	Rahovec
3	Kushtrim Zeka	Pataqan i Poshtëm	Sutki Hoti	Segment nga rr. e "Tyrbes"	Pataqan i Poshtëm
4	Teki Mustafa	Rahovec	Bajram Nurshaba	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
5	Teki Mustafa	Rahovec	Qamil Sylka	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
6	Teki Mustafa	Rahovec	Hamëz Hasku	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
7	Teki Mustafa	Rahovec	Xhyle Hajda	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
8	Teki Mustafa	Rahovec	Osman Mullabazi	Segment nga rr. "Dëshmorët e Pashtrikut"	Rahovec
9	Teki Mustafa	Rahovec	Emsale Shala	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
10	Teki Mustafa	Rahovec	Sakip Bugari	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
11	Teki Mustafa	Rahovec	Tefik Iska	Segment nga rr. " "	Rahovec
12	Teki Mustafa	Rahovec	Hidajet Haxhijaha	Segment nga rr. "Mexhid Mustafa"	Rahovec
13	Xhabir Hajrullaga	Rahovec	Halit Hajda	Segment nga rr. "Bekim Sylka"	Rahovec
14	Xhabir Hajrullaga	Rahovec	Sinan Hajda	Segment nga rr. " "	Rahovec
15	Xhabir Hajrullaga	Rahovec	Ymer Durguti	Segment nga rr. "Dëshmorët e Pashtrikut"	Rahovec
16	Xhabir Hajrullaga	Rahovec	Veli Topalli	Segmenti nga rr. "Xhelal Hajda - Toni"	Rahovec
17	Binak Berisha	Kramovik	Sali Rama	Segment nga rr. "14 Qershori"	Kramovik
18	Elami Kelmendi	Kramovik	Avdullah Kelmendi	Segment nga rr. "14 Qershori"	Kramovik
19	Ali Rudi	Dobidol	Arsim Rudi	Segment nga rr. "Çamëria"	Dobidol
20	Nexhemedin Krasniqi	Gexhë	Zymer Morina	Segment nga rr. "14 Maji"	Gexhë
21	Drilon Mustafa	Gur i Kuq	Zenel Himaj	Segment nga rr. "Idriz Seferi"	Gur i Kuq
22	Kujtim Rexhepi	Mrasor	Ukë Mrasori	Segment nga rr. "Pajazit Mrasori"	Mrasor
23	Kujtim Rexhepi	Mrasor	Muharem Rexhepi	Segment nga rr. "Pajazit Mrasori"	Mrasor
24	Kujtim Rexhepi	Mrasor	Ardit Mrasori	Segment nga rr. "Pajazit Mrasori"	Mrasor
25	Kujtim Rexhepi	Mrasor	Feriz Mrasori	Segment nga rr. "Pajazit Mrasori"	Mrasor
26	Kujtim Rexhepi	Mrasor	Sokol Rexhepi	Segment nga rr. "Pajazit Mrasori"	Mrasor
27	Skender Krasniqi	Opterushë	Xhemail Spahiu	Segmenti nga rr. "Sylejman Bytyqi"	Opterushë
28	Kasum Velu	Rahovec	Osman Velu	Segmenti nga rr. "Vëllezërit Frashëri"	Rahovec
29	Agron Shulina	Rahovec	Xhafer Shulina	Segment nga rr. "Bekim Isma"	Rahovec
30	Banorë të lagjes	Çifllak	Avdyl Mazreku	Segment nga rr. "Rilindja Kombëtare"	Çifllak
31	Selajdin Gashi	Çifllak	Vehbi Gashi	Segment nga rr. "Tahir Sinani"	Çifllak
32	Ymer Deliu	Rahovec	Bentullah Deliu	Segmenti nga rr. Ali Sokoli	Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education

**Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të Vitit
Shkollor 2023/2024**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

Drejtoria për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje



IV- Nr. I prot. 1540 Më 07.02.2024
Br. prot. Dt. 2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

Të nderuar!

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë periudhës së gjysmëvjetorit të parë është angazhuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo arsimor.

Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave, procesi mësimor i gjysmëvjetorit të parë pati filluar në të gjitha shkollat, sipas kalendarit vjetor të MASHTI-t.

Drejtoria Komunale e Arsimit kishte bërë gati një plan me një varg aktivitete dhe fillimisht kemi filluar vizitat e zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat.

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer disa punë dhe kemi zhvilluar disa aktivitete, siç vijon:

- ❖ Pas riparimeve të fundit e punimeve në projektin e efijencës, në objektin e shkollës “Rilindja” në Çifllak është bërë edhe riparimi i kulmit të ndërtesës;
- ❖ Në objektin e shkollës në Sapniq ka përfunduar ndarja fizike e 3 klasëve dhe janë krijuar kushte e mundësi që nxënësit e kësaj shkolle të mbajnë mësim vetëm në një ndërrim dhe kështu mundësua kursimi gati përgjysmë i shpenzimit të energjisë për ngrohje dhe për nevoja të tjera. E njëjta gjë u bë edhe në objektin e Shfmu “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq dhe në objektin e Shfmu “Dëshmorët e Lirisë në Pataqan të Poshtëm;
- ❖ Kemi përfunduar furnizimin me pelet në të gjitha shkollat të cilat e kanë në përdorim këtë lëndë djegëse për ngrohje. Morëm dy njoftime të shumëpritura, të cilat kanë të bëjnë me nënshkrimin e kontratës për furnizimin e çerdheve të reja me inventar dhe nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e objektit të ri të shkollës në Pastasel, projekte këto, të cilat fatkeqësisht akoma nuk kanë filluar së zbatuari;
- ❖ Ka vazhduar dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve arsimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në;
- ❖ U zhvillua dhe përfundoi me sukses ekskursioni i maturantëve i 4 SHML-ve dhe IAAP-së dhe çdo gjë gjatë ekskursionit ka vajtur mbarë;
- ❖ Mbajtëm takime periodike me drejtorët e shkollave, kryetarët e KDSH-ve dhe koordinatorët e cilësisë;

- ❖ Realizuar disa vizita në shkolla për t'u siguruar për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ekipi i inxhinierëve nga MASHTI, së bashku me inxhinierin e komunës sonë kanë bërë pozicionimin e objektit të ri të shkollës në Pastasel;
- ❖ Janë mbajtur ligjërata nga Policia e Komunitetit në temën “Siguria e përdorimit të internetit dhe mbajtëm një punëtori në temën” Funksionimi i qendrave mësimore për komitetet pakicë me bazë në shkollë” e cila u organizua dhe u mbajt në qytetin e Gjilanit;
- ❖ Në kuadër të projektit “Mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave të jashtme dhe të brendshme të objekteve publike” është punuar në objektin e Shfmu “Faik Konica” në Celinë dhe në objektin e Shfmu “Skënder Kastrati” në paralelen e ndarë në Gexhë;
- ❖ Është lidhur kontrata dhe menjëherë ka filluar furnizimi me dru i të gjitha shkollave, proces ky i cili përfundoi brenda dy javëve;
- ❖ Javën e fundit të nëntorit përruruar projektin e efijencës së energjisë në Shfmu “Faik Konica” në Celinë;
- ❖ Mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës Matematike, në të cilën garuan nxënësit e klasave 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 nga të gjitha shkollat e komunës sonë.
- ❖ Për nder të festave të nëntorit, bashkë me nxënësit e shkollave të mesme mbajtëm një orë letrare në bibliotekën e qytetit.
- ❖ Përruruar projektin “Ndikimi i rinisë në mjedis” të cilin e realizuan nxënësit e Klubit Ekologjik të SHML “12 Maji” në bashkëpunim me Caritasin Zviceran dhe organizatën “Ec ma ndryshe”.
- ❖ Punimet në projektet e ndërtimit të objekteve të reja të shkollave kanë vazhduar në Shfmu “Katër Dëshmorët” dhe punime përfundimtare ka pasur në Shfmu “Tre Dëshmorët”, e cila u përrurua më 5 dhjetor 2023.
- ❖ Në klasat 9-ta, 10-ta, 11-ta dhe 12-ta të SHFMU-ve dhe SHML-ve, vazhduan të mbahen garat shkollore të vlefshme për Garën e Olimpiadës së Fizikës në nivel komunal, e cila do të mbahet më 10 shkurt 2024;
- ❖ Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e parë, përfundoi të premten më 12 janar, 2024 dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 24 janar 2024.

Datë: 05.02.2024



Avni Morina, Drejtor i DKA-së

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Viti fiskal: 2023

Emri i zyrarit : Autoriteti Komunal i Kulturës	Komuna e Rahovecit	
Urgj i Autoritetit Komunal i Kulturës	Qeveritar	
Sodi buxhetor	623	
Adresa	Rr. "Xhihetal Hajda - Tomi" p.n.	
Kodi i postarit : Qyteti	21000 - Rahovec	
Tel. fiks/ Cellular/ Faks	038 200-45316	
Emri i menaxherit të prokurimit	Asiri Mullabazi	
E-mail adresa	prokurimi.rahovec@kks.gov.net & prokurimi.rahovec@gmail.com	
Adresa e webit të AK	http://kks.gov.net/rahovec/	

	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	
Lloji i Buxheti	Nazmi rendori i prokurimit	Nazmi brendshëm i prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 shifra e para të PPP)	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimit data e njohimit për anulim)	Aktet për implementimin e kontratës (shkruaj daten e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përmbylljes së kontratës (data e pranimt të përkohshëm/preliminar)	Vlera e parashikuar e kontratës	Gjumi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat c/j.	Gjumi i Ankes kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat c/j.	Zbatimet nga kontrata për shkakt të ndalesave	Bmri i OE të cilrit i bëhet dhënë kontrata	OB vendor (1) jo vendor (2)	Niveli i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara	Niveli i ofertave të refuzuara (shkruaj vlerën ato me cmimin më të ulët në krahasim me fituesin)	Mali kohor për pronarin komercial të tenderit	Vlerat për blerjen komerciale të favorshëm (2)	Paniki i Prokurimit		
i Hyrja Vendiante (1) ose Buxhti Komisi Kosovës (2) ose Donation	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
2	197	001	1	2	1	22	FURNIZIMI I BIBLIOTEKAVE ME LIBRA	18.01.2023	23.01.2023	28.02.2023	13.03.2023	13.03.2023 - 12.06.2023	12.06.2023	€ 20,000.00	€ 17,929.00	€ 0.00	€ 0.00	NTP „Arini “ Egre Çabje, PRISHTINE	1	12	2	0	1	1	1	
2	162	002	1	2	1	34	BLERIA EDY AUTOAMBULANCEVE	18.01.2023	20.01.2023	07.03.2023	10.03.2023	10.03.2023 - 08.06.2023	08.06.2023	€ 120,000.00	€ 109,998.00	€ 0.00	€ 0.00	"D & T Group" SH.P.K., Sudik Pozhegu / p.n., GIAKOVE	1	23	4	1				
2	179	003	5	1	1	45	NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I KANALIZIMEVE FEMALE (GROPA SEPTIKE) NË KOMUNEN E RAHOVECIT	18.01.2023	28.03.2023	15.06.2023	27.06.2023	27.06.2023 - 18.10.2024	18.10.2024	€ 697,279.36	€ 518,437.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operimeve Ekonomike: BAZALITI - S SH.P.K.; N.N.P. Nderimi; D & T Group SH.P.K.; N.P. Inova Sh.p.k., Debidot, Shaban Lishani p.n. 21000, Rahovec	1	50	5	0	2			

1	171	004	1	2	1	25	FURNIZIM ME GYPA PVC	18.01.2023	20.01.2023	15.03.2023	13.03.2023 - 13.03.2024	13.03.2024	€ 75,250.00	€ 57,125.00	€ 0.00	€ 0.00	"FINALING" SHEL P.K., Nibreti Genc N.C 74-1, PRISHTINE	1	48	6	1	1	1	Me plane
2	1752	005	2	3	6	37	SHERBIME PER TE GHITHA MANIFESTIME E AKTIVITETEVE KULTURORE PER VITIN 2023. SHERBIME ME LED PROFESIONAL, ZERIMIT DHE NDIRKIMIT PROFESIONAL PER NEVOJAT E KOMUNES SE RAHOVECIT - Rikunderim	19.01.2023	07.03.2023	19.04.2023	19.04.2023 - 18.02.2024	18.02.2024	€ 4,980.00	€ 4,980.00	€ 0.00	€ 0.00	GeoGroup Ing SHEL P.K., Rruga Idriz Beyri, Shtete Postime, 811492125	1	6	2	0	1	1	Me plane
2	261	006	2	2	1	93	MIREMBAJTJA E OBJEKTEVE KULLUKORE, MONUMENTEVE, FUSHAVE SPORTIVE DHE REKREATIVE	19.01.2023	26.01.2023	09.03.2023	09.03.2023 - 08.03.2024	08.03.2024	€ 12,058.00	€ 8,614.75	€ 0.00	€ 0.00	GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SHEL P.K., Sheshi Illi Maliqi, RAHOVEC	1	28	4	0	1	1	Me plane
2	1404	007	2	1	1	90	MIBELJA DHE MIREMBAJTJA E LULEVE NE RAFTESIRA PUBLIKE - Rikunderim	23.01.2023	28.02.2023	18.04.2023	18.04.2023 - 17.04.2024	17.04.2024	€ 12,430.00	€ 11,900.00	€ 0.00	€ 0.00	Bedri A. Xyaziu B.L., Xarxa, Rahovec	1	10	3	1	1	1	Me plane
2	7605	008	2	2	1	74	MIRKEDRYRIA E INVESTIMEVE KAPITALE NE KOMUNEN E RAHOVECIT - Rikunderim	23.01.2023	25.07.2023	12.09.2023	12.09.2023 - 11.09.2025	11.09.2025	€ 80,000.00	€ 80,000.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik P.M.N. SHEL P.K., N.P.N. UNIVERS- MI Trajballoq ob. 2 Nr. 1/6, PRISHTINE	1	19	1	0	2	1	Me plane
2	321	009	2	1	1	74	HARTIMI I PROJEKTEVE TE NDRYSHME NE KOMUNEN E RAHOVECIT	25.01.2023	01.02.2023	30.03.2023	30.03.2023 - 27.03.2026	27.03.2026	€ 350,000.00	€ 350,000.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik PROUNG&PARNES SHEL P.K., GEOCAD Group SHEL P.K., K.e Djalit Major M. Bushi Lam 12/11 Z. Peredimi, Prishtine	1	48	3	0	2	1	Me plane
2	490	010	1	3	6	33	FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PER NEVOJAT E QKMF - se	26.01.2023	02.02.2023	05.03.2023	05.03.2023 - 05.03.2024	05.03.2024	€ 2,520.00	€ 2,260.50	€ 0.00	€ 0.00	"INFINITI" SHEL P.K., Dëshmoret e Kombit, PRISHTINE	1	10	4	0	1	1	Me plane
2	491	011	2	2	1	50	SERVISIM I PAISIEVE MJEKESORE	30.01.2023	03.02.2023	09.03.2023	09.03.2023 - 09.03.2026	09.03.2026	€ 96,000.00	€ 96,000.00	€ 0.00	€ 0.00	KosovabMed Heulbeure SHEL P.K., Rr. Ndue Ferizliu K.P., Lok Nr.1, Prishtine, PRISHTINE	1	9	1	0	1	1	Me plane
2	434	012	2	2	1	74	KONSULENCE PER HARTIMIN E PROJEKTEVE PER FERMERI DHE BIZNESE	30.01.2023	31.01.2023	01.03.2023	01.03.2023 - 01.03.2025	01.03.2025	€ 50,000.00	€ 50,000.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. BOKOS TRIANGLE SHEL P.K., Gjakocë, Shtete, Shtete	1	33	1	0	2	1	Me plane
2	560	013	1	3	6	23	FURNIZIM ME PAKO PEDAGOGJIKE	01.02.2023	03.02.2023	10.03.2023	10.03.2023 - 07.07.2023	07.07.2023	€ 9,720.00	€ 6,888.20	€ 0.00	€ 0.00	A.R.F. SHEL P.K., Xheve Lladrovci, FUSHI KOSOVE	1	17	4	0	1	1	Me plane
2	578	014	2	2	1	93	HARTIMI I PLANIT LOKAL PER CITESINE E AJRIT	01.02.2023	07.02.2023	24.04.2023	24.04.2023 - 23.01.2024	23.01.2024	€ 30,000.00	€ 27,787.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik Albo Group SHEL P.K., N.SH GEO - MENINGU, Rr. "Hyzi Talla", Prishtine	1	20	2	0	1	1	Me plane

2	6893	030	5	2	1	45	NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF-ve DHE AMP-ve - Rikendrim	10.03.2023	07.07.2023	12.09.2023	19.09.2023	19.09.2023 - 10.01.2025	10.01.2025	€ 379,898.88	€ 378,392.62	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatoreve Ekonomik: AVAG GROUP SH.P.K., EING COM SH.P.K., Fadi Gajgeviç Nr.24/1, Prishtinë	1	41	4	3	1	1	Me plane
2	9402	031	5	1	1	45	NDËRTIMI QENDRËS RINORE DHE KULTURËRE NË RAHOVEC - Rikendrim	16.03.2023	06.09.2023	18.10.2023	20.10.2023	20.10.2023 - 05.06.2026	05.06.2026	€ 2,982,063.00	€ 2,982,584.55	€ 0.00	€ 0.00	NPN EUROING SH.P.K., XERXHI RAHOVEC	1	36	2	1	2	2	Me plane
1	2486	032	1	2	1	21	FURNIZIMI ME MATERIAL ADMINISTRATIV, TË CILAT NUK JAVËTË PËRFSHIRË NË KONTRATIN E AQP - së	16.03.2023	24.03.2023	18.05.2023	21.05.2023	23.05.2023 - 22.05.2026	22.05.2026	€ 95,000.00	€ 95,000.00	€ 0.00	254.69 Euro - Çmimi për njësi me postim	"INFINITI" SH.P.K., Dedineç e Kombit, PRUSHITË	1	17	3	0	1	1	Me plane
1	2957	033	1	2	1	28	PAJISJA E SHKOLLAVE ME MIETE KONKRETEZUESHE DHE LABORATORIKE	20.03.2023	31.03.2023	11.05.2023	18.05.2023	18.05.2023 - 17.06.2023	17.06.2023	€ 20,000.00	€ 18,565.65	€ 0.00	€ 0.00	BEHAR RAMA B.L., Xhelal Hida Tomi Pa RAHOVEC	1	17	2	0	1	1	Me plane
1	2855	034	1	2	1	33	FURNIZIMI DHE INSTALIMI I KAMERAVE TË SIGURISË NË OBJEKTET E KOMUNES DHE NË QYTET	27.03.2023	03.04.2023	-	-	-	-	€ 40,000.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	ANULIM	1	0	0	0	1	1	Me plane
2	3087	035	5	2	1	45	MERENETIMI I RRUGËVE DHE TRUTUAREVE - LOT 1	31.03.2023	04.04.2023	30.05.2023	13.06.2023	13.06.2023 - 12.06.2026	12.06.2026	€ 380,000.00	€ 380,000.00	€ 0.00	748.50 Euro - Çmimi për njësi me postim	Grup i Operatoreve Ekonomik: ADEA CONSTRUCTION SH.P.K., NIN SH WORLD MEDIUM, NDËRTIMING SH.P.K., Rrahovca Cosence SH.P.K., densus, Gllodur	1	30	2	1	1	1	Me Konfirmim ne AQP
2	3431	036	5	2	1	45	RENOVIME NË SHKOLLA	03.04.2023	19.04.2023	06.07.2023	13.07.2023	13.07.2023 - 13.07.2026	13.07.2026	€ 374,383.00	€ 332,017.85	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatoreve Ekonomik: N.N.P. EURO CONSTRUCTION, IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K., D & T Group SH.P.K., Rrafoc, Rrafoc - Rrafoc	1	82	3	1	1	1	Me plane
1	7702	037	5	2	1	45	NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE - Rikendrim	03.04.2023	25.07.2023	09.10.2023	12.10.2023	12.10.2023 - 03.02.2025	03.02.2025	€ 126,577.90	€ 127,027.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatoreve Ekonomik: Agim Trolli B.L., TRIANGLE SH.P.K., Subotëriq, Bregada 123	1	23	3	1	1	1	Me plane
2	3318	038	5	1	1	45	NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT 3	04.04.2023	04.07.2023	12.09.2023	18.09.2023	18.09.2023 - 09.01.2025	09.01.2025	€ 1,065,500.00	€ 1,049,999.50	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatoreve Ekonomik: KAG OIL SH.P.K., N.N.T. Eniku, Rr. Afrim Gashi, Landovise, Prizren	1	44	5	3	2	2	Me Konfirmim ne AQP
2	3454	039	5	2	1	45	RIPARIMI OBJEKTIVË TË GJENDJES CIVILE	07.04.2023	13.04.2023	13.06.2023	27.06.2023	27.06.2023 - 21.02.2024	21.02.2024	€ 90,616.50	€ 47,777.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatoreve Ekonomik: IZO - H SH.P.K., MONTING SH.P.K., Mëz Gllani SH-S / Nr. 4321 A/-1, 10000, Prishtinë	1	40	10	0	1	1	Me plane

2	9790	060	1	1	1	02	FURNIZIM ME DRU AHU PER VITIN SHKOLLOR 2023/2024	11.09.2023	19.09.2023	13.11.2023	14.11.2023	14.11.2023 - 13.11.2024	13.11.2024	€ 160,000.00	€ 142,422.20	€ 0.00	€ 0.00	N.P.T. Hanc' Rr UCK-68 RAHOVEC	1 13 6	2	1	Me plane
1	10422	061	5	3	6	45	NDERITIMI I TERRENEVE NE SHPALLJE GJIZIM HANZA - PIKTORI NE RAHOVEC	26.09.2023	29.09.2023	31.10.2023	06.11.2023	06.11.2023 - 04.03.2024	04.03.2024	€ 9,800.00	€ 8,210.00	€ 0.00	€ 0.00	"IZO - H" SH.P.K. Rr:Z Gllani SU-57 Nr.431 A/1, Pristine	1 14 4	1	1	Me Konfirmim ne AQP
1	12282	062	5	2	1	45	RRGJILLIMI I TERRENEVE SPORTIVE DHE HAPESIRAVE REKREATIVE PER TE RINJ - Rr:ndem	26.09.2023	07.11.2023	-	12.12.2023	-	-	€ 107,876.68	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	ANULIM	1 27 2	1	1	Me Konfirmim ne AQP
2	10541	063	1	3	6	28	FURNIZIMI DHE MONTIMI I FRIGDHOHES PER DEBONIM TE USHQIMIT PER QERDHEN E FEMIJVE "TULIPANET"	26.09.2023	02.10.2023	-	19.10.2023	-	-	€ 6,850.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	ANULIM	1 10 1	1	1	Me Konfirmim ne AQP
2	10579	064	1	1	1	24	FURNIZIM ME PLES ARTIFICIAL	26.09.2023	03.10.2023	-	-	-	-	€ 500,000.00	-	-	-	NE PROCEDURE	1 21 3	1	1	Me plane
2	10731	065	1	2	1	33	FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MIKESOR PER NEVOJAT E QKMF - 68 LOT I - FURNIZIM ME MATERIAL REAGJENSA SHPENZUES PER LABORATOR	03.10.2023	17.10.2023	16.11.2023	29.11.2023	29.11.2023 - 28.11.2024	28.11.2024	€ 10,419.00	€ 9,232.00	€ 0.00	€ 0.00	MADEKOS SH.P.K. Vragoli (Magjistaria Pristina-Peje), Fusha Koscove	1 26 1	1	1	Me plane
2	10731	065	1	2	1	33	FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MIKESOR PER NEVOJAT E QKMF - 68 LOT II - FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PER STOMATOLOGJI	03.10.2023	17.10.2023	29.11.2023	04.12.2023	04.12.2023 - 03.12.2024	03.12.2024	€ 6,932.50	€ 6,497.70	€ 0.00	€ 0.00	PRO MEDICAL SH.P.K. Rr: Kadin Zekia, Ferizaj	1 26 2	1	1	Me plane
2	10731	065	1	2	1	33	FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MIKESOR PER NEVOJAT E QKMF - 68 LOT III - FURNIZIM ME BARNA AMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR	03.10.2023	17.10.2023	29.11.2023	01.12.2023	01.12.2023 - 29.11.2024	29.11.2024	€ 69,388.00	€ 39,955.00	€ 0.00	€ 0.00	MADEKOS SH.P.K. Vragoli (Magjistaria Pristina-Peje), Fusha Koscove	1 26 4	1	1	Me plane
2	10731	065	1	2	1	33	FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MIKESOR PER NEVOJAT E QKMF - 68 LOT IV - FURNIZIM ME FILMA PE RENTGEN	03.10.2023	17.10.2023	16.11.2023	23.11.2023	23.11.2023 - 22.11.2024	22.11.2024	€ 14,121.67	€ 13,940.70	€ 0.00	€ 0.00	Kosovabed Healthcare SH.P.K. Rr: Ndue Perllushi K.P. Lok Nr.1, Pristine, PRISTINE	1 26 1	1	1	Me plane

2	12344	072	5	2	1	45	RRREGULLIMI DHE RIPARIMI I TERRENEVE SPORTIVE	30.10.2023	08.11.2023	06.12.2023	07.12.2023	07.12.2023 - 05.12.2025	05.12.2025	€ 460,000.00	€ 459,805.35	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. VETONI N.N.P. EURO CONSTRUCTION. SOPNIQ RAHOVECI	1	40	1	0	1	1	Me Konfirmim ne AQP
2	12004	073	5	1	1	45	RRREGULLIMI SHTRAJTIT TE FLUMIT DHE KOLEKTORIT NE KRUSHË TE MADHE DHE OPTERISHTË	31.10.2023	14.12.2023					€ 1,060,518.45				NË PROCEDURË					1	2	Me plane
1	12027	074	5	2	1	45	RRREGULLIMI OBOORRIT TE LOKALET ZETARE DHE VENDOSJA E DRITAREVE	31.10.2023	01.11.2023	05.12.2023	06.12.2023	06.12.2023 - 05.12.2024	05.12.2024	€ 66,512.80	€ 64,870.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik I POWER KOSOVA SHPK, N.P.T. Banius, Brigada 123, Sullarska	1	20	3	1	1	1	Me Konfirmim ne AQP
1	12593	075	1	3	6	24	FURNIZIM ME VAKSINA PËR BACËTII	08.11.2023	14.11.2023	29.11.2023	05.12.2023	05.12.2023 - 03.01.2024	03.01.2024	€ 3,125.00	€ 2,551.00	€ 0.00	€ 0.00	MONUNI SH.P.K. Rr. Washingtonit nr 65, GJILAN	1	9	2	0	1	1	Me plane
2	12928	076	2	1	1	93	PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE E OBJEKTIVE TË KOMUNËS SË RAHOVECI Lot 1 - MIRËMBAJTJA E OBJEKTIVE TË KOMUNËS	17.11.2023	30.11.2023	13.01.2024	26.01.2024	26.01.2024 - 23.01.2026	23.01.2026	€ 155,000.00	€ 155,000.00	€ 0.00	€ 0.00	NSH"ZONA PARK" PARKUI QYTETIT, PRIZREN	1	36	2	0	2	1	Me Konfirmim ne AQP
2	12928	076	2	1	1	93	PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE E OBJEKTIVE TË KOMUNËS SË RAHOVECI Lot 2 - MIRËMBAJTJA E OBJEKTIVE SHËNDËTËSORE	17.11.2023	30.11.2023	18.01.2024	26.01.2024	26.01.2024 - 23.01.2026	23.01.2026	€ 155,000.00	€ 155,000.00	€ 0.00	€ 0.00	Grup i Operatorëve Ekonomik: MBUROVA SH.P.K. Bfa Dinsalstang GmbH - Dega në Kosovë, Rrugë William Walter, p.a. Prizren	1	36	2	0	2	1	Me Konfirmim ne AQP
2	13129	077	2	1	1	45	GRUMBULLIMI MBETURINAVE DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE GJATË DY SEZONAVE GRUMBULLIMI I MBETURINAVE DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE GJATË DY SEZONAVE - Lot 1	22.11.2023	05.01.2024	30.01.2024	02.02.2024	02.02.2024 - 01.02.2027	01.02.2027	€ 258,540.48	€ 258,501.48	€ 0.00	€ 0.00	KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE EKOREGJIONI SH.A. REGIONAL WASTE COMPANY EKOREGJIONI, RR. Fahir Stani nr.59, Prizren	1	33	2	0	2	1	Me plane
2	13129	077	2	1	1	45	GRUMBULLIMI MBETURINAVE DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE GJATË DY SEZONAVE GRUMBULLIMI I MBETURINAVE DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE GJATË DY SEZONAVE - Lot 2	22.11.2023	05.01.2024	30.01.2024	02.02.2024	02.02.2024 - 01.02.2027	01.02.2027	€ 440,995.92	€ 416,542.80	€ 0.00	€ 0.00	EKO-DRINTA SH.P.K. Ratkoc, RATKOC	1	33	2	0	2	1	Me plane
2	13234	078	1	2	1	02	FURNIZIM ME PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECI PËR VITIN 2023/2024	23.11.2023	28.11.2023					€ 124,540.00				NË PROCEDURË					2	1	Me plane
														€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00								
														€ 16,076,600.70	€ 15,298,311.29	€ 0.00	€ 0.00								



Republika e Kosovës



Komuna e Rahovecit

Referencë:	Vendimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit për Themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale 01 Nr. 326/22 i datës 31.05.2022 Udhëzimi Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.
Për:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
Cc:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Rahovec z.Arbër Zenuni
Përmes:	Kryesueses së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale znj. Vlora Vuçitërna
Nga:	Anëtarët e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale: 1. Vlora Vuçitërna 2. Shukrije Himaj 3. Lirigzon Kastrati 4. Zana Qmega 5. Armir Vuçitërna
Lënda:	Raporti Vjetor i Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023
Data:	09/02/2024

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Rahovecit,
I nderuari Kryesues i Kuvendit,

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, konkretisht neni 16 pika 3 të po këtij udhëzimi administrativ dhe akteve tjera ligjore të Komunës së Rahovecit, Kuvendit të Komunës ia dorzojmë raportin vjetor të punës së komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale për vitin 2023.

Raport mbi punën e deritanishme të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale JANAR-DHJETOR 2023

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është themeluar me vendimin 01 Nr. 326/22 i datës 31.05.2022 të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka këtë përbërje si vijon:

- 1.Vlora Vuçitërna Omega , anëtare nga subjekti politik LVV , Kryesuese e Komitetit
2. Shukrije Himaj, anëtare nga subjekti politik AAK
- 3.Lirigzon Kastrati, anëtar nga subjekti politik LDK
- 4.Zana Omega, eksperte e jashtme
5. Armir Vuçitërna, anëtar nga subjekti politik PDK

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin parësor shëndetësor:

Përkujdeset për zbatimin e shërbimeve për kujdesin parësor shëndetësor në komunë.

Shqyrton propozimet e drejtorit të QKMF-së dhe të Entit për Emergjencë nëpërmjet DSHPS.

Shqyrton buxhetin për sektorin e Shëndetësisë dhe ia dorëzon atë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim.

Shqyrton dhe jep propozime dhe sugjerime për projekt-planin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale.

Shqyrton raportin vjetor, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe mund të propozojë ndryshime ose plotësime dhe t'ia dërgojë KPF – së dhe Kuvendit për miratim.

Shqyrton dhe propozon programe për mbështetjen komunale grupeve të varfra të njerëzve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetimë, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët etj.) dhe propozon masa përkatëse.

Mbështet Drejtorinë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave në lidhje me strehimin.

Vlerëson propozimet e drejtorisë për strategjitë dhe planet e strehimit, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, renovimin e tyre si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për këto qëllime.

Shqyrton programet, në raste emergjente, për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre.

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë vitit 2023 ka mbajtur 6 (gjashtë) takime të rregullta.

Mbledhja e parë e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023 është mbajtur me datë 28 Shkurt 2023 (e martë) ku pikë e rendit të ditës ishte shqyrtimi I planit të veprimit I këtij komiteti për vitin 2023. Gjatë këtij takimi anëtarët e komitetit vendosën që gjatë vitit 2023 të mbahen këto vizita:

Vizitë në QMF, Krushë e Madhe;

Vizitë në AMF, Xërxe;

Vizitë në AMF-të në Rahovec;

Takim me këshillin e pacientëve;

Vizitë në QKMF, Rahovec;

Vizitë në QMF, Ratkoc.

+



Mbledhja e dytë e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale u mbajtë me datë 29 Prill 2023. Pikë e rendit të ditës ishte vizitë ne Qendrën e Mjekësisë Familjare në Krushë të Madhe ku u pritën nga stafi shëndetësor I kësaj qendre. Kjo qendër ofron shërbime për dhjetra e qindra banorë në muaj. Gjatë takimit diskutuam rreth nevojave dhe kërkesave të kësaj qendre. Kërkesë kryesore e tyre ishte funksionalizimi I aparatit për analiza biokimike, aparat ky I cili ishte donacion nga familja e Dr. Fahredin Hoti. Sfidë me të cilën përballlet kjo qendër është mungesa e barnave dhe produkteve higjienike. Kjo qendër gjatë gjithë vitit ishte pa kryeshf.



Qendra e Mjekësisë Familjare kishte nevojë edhe për Renovim të Objektivit pasi që pas të reshurave të shiut kulmi i objektit nuk është në gjendjen e duhur, pas reagimit tonë në seancë ka filluar edhe renovimi i objektit në këtë qendër.

Mbledhja e tretë e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë 27 Qershor 2023 ku ndër pikë të rendit të ditës ishin vizitë në AMF - Xërxe dhe AMF - Rahovec. Gjatë vizitës në AMF në Xërxe së bashku me anëtarë tjerë të komitetit u takuam me udhëheqësin e kësaj qendre dhe me pjesën tjetër të personelit shëndetësor. Ndër kërkesë kryesore e tyre ishte që kjo AMF të shëndrrohet në QMF. Sfidat me të cilat përballej stafi gjatë punës së tyre është

mungesa e barnave sidomos disa ilaqeve për fëmijë dhe mungesa e produkteve higjienike përkundër vullnetit të madh që kanë për punë, si dhe problem me ndriçim në disa dhoma ku kryhen intervenime të vogla.

Pas kësaj vizite komiteti shëndetësi dhe përkujdesje sociale vazhdoi vizitën në AMF në lagjen e poshtme në Rahovec ku u mirëpritë nga doktoresha Fjolla Kadiri. Kërkesë kryesore e stafit ka qenë që të gjindet një mënyrë për t'i vetëdijësuar banorët e kesaj lagje, se vizitat tani mund ti kryejnë edhe në këtë AMF, duke e pasur parasysh që në këtë AMF më herët janë kryer në numër më të madh vetëm vizitat stomatologjike.



+

Mbledhja e radhës me anëtarë të komitetit është mbajtur me 27 Tetor ditë e premte. Gjatë kësaj mbledhje u diskutuan tema të ndryshme ku pikë e rendit të ditës ishte vizitë në QMF në Ratkoc.



Gjate vizitës komiteti u takua me personelin shëndetësor të kësaj QMF-je. E njejta sfidë me të cilët ballafaqohet personeli shëndetësor ishte edhe në Ratkoc , mungesa e barnave esenciale dhe mungesë e madhe e produkteve higjienike ku ndër tjerash personeli shumicën e herave detyrohet vet ti blej këto produkte.

Mbledhja e pestë e komitetit u mbajt me 27 Nëntor të vitit 2023. Gjatë kësaj mbledhje komiteti vizitoi QKMF-në në Rahovec. U mbajt një takim me drejtorin z. Elbunit Kryeziu dhe drejtoreshën

e shëndetësisë znj. Saranda Salltëku. E pranishme ishte edhe kryeinfermierja zonja Bukurie Qanta dhe nje pjesë tjetër e personelit shëndetësor.



Gjatë këtij takimi u diskutua rreth sfidave me të cilët përballëj stafi gjatë vitit 2023, u vizituan dhomat në QKMF e në veçanti pjesa e renovuar e QKMF-së. Gjatë kësaj vizite hasëm në dhomën e infuzioneve e cila ishte e mbyllur dhe jashtë funksionit ku pas reagimeve të shumta edhe kjo u rregullua dhe u ndanë dhomat për marrje të infuzioneve nga ato të intervenimeve të vogla.

Mbledhja e gjashtë e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale u mbajtë me datë 27 Dhjetor të vitit 2023.

Gjatë kësaj mbledhje komiteti ka kryer këto vizita : Vizitë në AMF në lagjen e epërme ku fatkeqësisht kjo AMF në momentin e vizitës ishte e mbyllur përkundër asaj që udhëheqësit ishin të njoftuar. Pas kësaj vizita vazhdoi në AMF në lagjen e komuniteteve. Anëtarët e komitetit vizituan këtë AMF ku u pritën nga doktoresha e pranishme. Gjatë takimit doktoresha na njoftoi rreth asaj se si funksionon kjo AMF dhe me sfidat me të cilat përballëj. Kërkesë kryesore e doktoreshës ka qenë që edhe kjo AMF të furnizohej me reagjenta laboratorike meqenëse kjo AMF ishte e pajisur me dy aparate për kryerjen e analizave biokimike. Kërkesë tjetër ishte që të funksionalizohej pjesa e kryerjes së vizitave stomatologjike.

Gjatë kësaj vizite komiteti për shëndetësi u takua edhe me këshillin e pacientëve në QKMF . Anëtarët e komitetit u pritën nga z. Selman Shtavica – anëtar I këshillit të pacientëve. Komiteti u informua rreth ankesave të pacientëve që në numër për gjithë vitin ishin vetëm 5.

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale duke pasur parasysh kërkesat e institucioneve të cilat i ka vizituar gjatë kësaj periudhe i propozon DSHPS që ti ketë parasysh në formë rekomandimi edhe nga ana e këtij Komiteti me qëllim të plotësimit të nevojave dhe kërkesave për këto institucione e të cilat do të reflektonin pozitivisht edhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e komunës së Rahovecit...

Kryesuesi-ja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale:

Vlora Vuçitërna Cmega





Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës në Rahovec 01. Nr. 324/22 i datës 31.05.2022, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2022 merr këtë:

VENDIM

Për përbërjen dhe organizimin e Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

1. Me këtë vendim caktohet përbërja dhe organizimi i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
2. Komiteti i caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet nga 5 (pesë) anëtar, ku shumica e anëtarëve përbëhet nga anëtarët e kuvendit si dhe duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit jasthë kuvendit të Komunës që janë ekspert të fushës përkatëse.
3. Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit ka këtë përbërje:
 - 3.1. Shukrije Himaj AAK;
 - 3.2. Vlora Vuçitërma LVV;
 - 3.3. Lirigzon Kastrati LDK;
 - 3.4. Amir Vuçitërma PDK;
 - 3.5. Edmond Kabashi ekspert i jashtëm;
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë.
5. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.326/22
Me datë:31.05.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e Auditimit të Brendshëm Komuna e Rahovecit

	REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY RAHOVEC		
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/ KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/ MUNICIPAL MAYOR'S CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	3866	Nr. i faq./Br.str./No.pg 90
Data/Datum/Date	20/ 2 / 2024	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

RAPORT INFORMUES PËR PUNËN E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023

Janar, 2024

Raporti i punës së NJAB-së për periudhë: Janar - Dhjetor të vitit 2023

Në perudhën Janar – Dhjetor, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2023, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023, kemi arritur të kryejm 6 auditime, kemi dhënë 21 rekomandime, 11 rekomandime janë zbatuar, kurse 10 janë në proces.

Drejtoritë e audituara të planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023

1. Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale.
2. Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
3. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme.
5. Auditimi i Brendshëm i Performancës për projektin: Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit.
6. Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet.

Auditimi Nr. 1 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale

Çështja 1 - Nuk ekziston një planifikim i mirëfillt i analizuar i definuar dhe i destinuar drejtë, për të hyrat e përgjithshme dhe këtë e vërteton diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit.

KONKLuzion: Planifikimi i të hyrave që nuk bazohet në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.

REKOMANDIMI 1 - Rekomandojm që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike. Drejtoria e audituar duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.

Çështja 2 - Procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronën shtetore për vendosjen e objekteve të përkohshme për periudhën deri në një (1) vit, rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale. Komuna ka aprovuar rregullore të brendshme për vendosjen e objekteve të përkohshme në teritorin e Komunës së Rahovecit.

KONKLuzion: Neglizhimi i procedurave të shkruara në mos lidhjen e kontratave të objekteve të përkohshme të vendosura në pronën shtetore, dëmton konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të të interesuarve. Mos vazhdimi i kontratave me kohë në vitin vijues rrit rrezikun e mos inkasimit të të hyrave duke i sjell humbje financiare Komunës.

REKOMANDIMI 2 - Rekomandojm Drejtorin e Shërbimeve Publike që të siguroj që kontraktuesit të lidhin kontratë në kohë dhe afatet e përcaktuar me rregullore, për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes publike, ose të zhvillohet procedura në bazë të konkurrencës dhe trajtimit të barabart të të interesuarve.

Çështja 3 - Gjatë mostrimit që kemi marrur për periudhën audituese për vendosjen e objekteve të përkohshme Mars 2023, vërejmë se deri më tani janë lidhur vetëm 6 kontrata, janë bërë 7 kërkesa dhe ende nuk kanë lidhur kontratë, 6 nuk kanë bërë ende kërkesë. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit të hapsirës publike me garazha gjatë vitit 2022 konkludojmë se nga 18 objekte (garazha) 9 kanë pasur kontratë kurse 9 të tjera kanë pasur Vendim për Largim.

KONKLUZION: Neglizhimi i procedurave të shkruara, mos marrja e masave dhe mos zbatimi i rregullores në mos lidhjen e kontratave të objekteve të përkohshme të vendosura në pronën shtetërore, dhe mos ekzekutimi i vendimeve për largimin e objekteve përbën shkelje të rregullores 01 Nr.2558.

REKOMANDIMI 3 - Rekomandojmë Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë për Punë Inspektuese (inspektorin e ndërtimit) që të ndërmarrin masat e menjehershme për Largimin ose Mbylljen e Objekteve, neni 19 si dhe ekzekutimin e vendimeve për zbatimin e nenit 25, Dispozitat Ndëshkuese të rregullores 01 Nr.2558.

Auditimi Nr. 2 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Çështja 1 - Planifikimi i të hyrave vetanke për çdo kategori të hyrave bëhet duke marrë për bazë potencialin ekzistues dhe lartësinë e taksave të cilat aplikohen për çdo kategori, mos realizimi i të hyrave sipas planit dhe paraqitje e pengesave në arkëtimin me kohë dhe të saktë rezulton me mos realizimin e të hyrave sipas planifikimit vjetor dhe humbjen e të hyrave.

Konkluzion: Mungojnë procedura të shkruara të detajuara në të cilat parashihen veprimet konkrete në çdo situatë prej nënshkrimit të kontratës e deri te kthimi në menaxhim të pronës komunale dhe fillimin e procedurës për ankandin e ardhshëm.

Rekomandimi 1 – Rekomandohet drejtori i drejtorisë së audituar të siguroj një procedurë të brendshme të shkruara të detajuar lidhur me menaxhimin e kontratave të qirave në mënyrë që të krijohet një kontroll efikas i brendshëm për evitimin e rasteve të shfrytëzimit të pronës komunale pa kontratë dhe pa kryer obligimet me kohë.

Çështja 2 - Disponueshmëria e informatave të sakta të cilat azhurnohen në mënyrë sistematike lidhur me arkëtimet dhe reflektimin e tyre në ndryshimin e llogarive të arkëtueshme i mundëson menaxhmentit që në çdo kohë të marrë informata lidhur me lëvizjen dhe progresin e arkëtimeve dhe zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Ne kemi pritur të gjejmë se lidhur me procesin e arkëtimit të hyrave nga qiraja në pronën komunale janë krijuar evidenca të cilat mundësojnë që pas çdo arkëtimi të mjeteve të ndryshohen, gjegjësisht të zvogëlohen llogarit e arkëtueshme.

Konkluzion: Edhe pse ka pasur evidenca për regjistrimin e të hyrave nga pronat komunale mos inkasimi i të arkëtueshmeve për çdo obligues ka rezultuar që në fund të vitit të paraqitet gjendja e llogarive të arkëtueshme me borxhe.

Rekomandimi 2 – Rekomandohet drejtori i drejtorisë së audituar të siguroj se bëhet inkasimi i të arkëtueshmeve përmes inicimit të procedurave gjyqësore për arkëtimin e borgjit të pa arkëtuar si dhe shkëputjet e kontratave për shfrytëzuesit e objekteve komunale të cilët nuk respektojnë afatet e pagesave sipas kontratës dhe inicimin e procedurave përmes avokatit publik për arkëtimin e detyrueshëm të të hyrave me procedurë përmbarimore.

Çështja 3 - Disponueshmëria e informatave të sakta të cilat azhurnohen në mënyrë sistematike lidhur me arkëtimet dhe reflektimin e tyre në ndryshimin e llogarive të arkëtueshme i mundëson menaxhmentit që në çdo kohë të marrë informata lidhur me lëvizjen dhe progresin e arkëtimeve dhe zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Ne kemi pritur të gjejmë se lidhur me procesin e arkëtimit të hyrave nga taksat komunale në afarizëm janë krijuar evidenca të cilat mundësojnë që pas çdo arkëtimi të mjeteve të ndryshohen, gjegjësisht të zvogëlohen llogarit e arkëtueshme.

Konkluzion: Edhe pse ka pasur evidenca për regjistrimin e të hyrave nga taksat komunale, mos inkasimi i të arkëtueshmeve për çdo obligues ka rezultuar që të krijohen borxhe të kqia dhe të paraqitet gjendja e llogarive të arkëtueshme me borxhe.

Rekomandimi 3 – Rekomandohet drejtori i drejtorisë së audituar të siguroj se bëhet inkasimi i të arkëtueshmeve të taksave komunale përmes inicimit të procedurave gjyqësore për arkëtimin e borxhit të pa arkëtuar për të gjitha bizneset të cilët nuk respektojnë afatet e pagesave sipas ngarkesës vjetore me aktvendim dhe inicimin e procedurave përmes avokatit publik për arkëtimin e detyrueshëm të të hyrave me procedurë përmbartimore.

Çështja 4 - Sektorët që arkëtojnë të hyra, plotësojnë fatura të UNIREF-it për ngarkesat dhe taksa, me të cilat subjektet e caktuara i kryejnë pagesat në banka në llogarinë e komunës, pas lëshimit të faturave për kryerjen e pagesave dhe pranimin të kopjes së vulosur nga banka, zyrtarët që janë të kyçur në procesin e arkëtimit të hyrave bëjnë regjistrimin e të hyrave në mënyrë sistematike dhe në fund të muajit kryejnë barazimin e të dhënave me zyrtarin e të hyrave komunale për tu siguruar se të gjitha pagesat e regjistruara janë proceduar si duhet, pasi që mund të ndodh që një subjekt e ka marrë faturën por nuk e ka kryer pagesën në bankë. Ne kemi pritur të gjejmë se në drejtorinë për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, përveç që ekzistojnë evidenca për regjistrimin e të hyrave, por edhe ekziston një procedurë e rregullt për barazimin e të dhënave të regjistruara në këto evidenca me të dhënat e regjistruara në evidencën kontabël dhe të dhënat e zyrtarit për të hyrat komunale të cilat i nxjerr nga llogaria e komunës në bankë.

Konkluzion: Ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme, sidomos në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuat në planifikimin sa më të saktë të buxhetit, edhe pse ekziston një praktik e mirë për barazimin e të hyrave të sektorit për ekonomi dhe zhvillim me zyrtarin e të hyrave, duhet vendosur kontrolle mbi procesin e barazimit të të hyrave në mes zyrtarit të drejtorisë dhe zyrtarit për të hyra komunale.

Rekomandimi 4 – Rekomandohet drejtori i drejtorisë së audituar të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake. Drejtoria e audituar të ndërmerr të gjitha masat që në të ardhmen të mos paraqiten mosbarazime në mes zyrtarit të drejtorisë dhe zyrtarit për të hyra komunale.

Çështja 5 - Për shkak të mungesës së burimeve njerëzore jo të mjaftueshme, punët në sektorin për taksa komunale kanë ngelur mrapa (të pa përfunduara), punët në këtë sektor kryen vetëm një punëtorë e punësuar me kontratë me afat të caktuar. Gjatë periudhës tre mujore, dhe deri në kohën e pregaditjes së këtij raporti, sektori për taksa komunale ka ngarkuar bizneset me taksë komunale në bazë të rregullores për taksa komunale nr.80/20 të datës 29.06.2020, por aktvendimet nuk janë pregaditur dhe shpërndar tek bizneset.

Konkluzion: Ekziston nevoja për përforcim të mëtejshme të kontrollës së brendshme, sidomos në pregaditjen dhe shpërndarjen e aktvendimeve, të zbatohet vendimi i Kuvendit Komunal, komisioni jo profesional për vlerësimin e ankesave, duhet vendosur kontrolle mbi procesin faljes së borxheve pa bazë ligjore nga ana e komisionit.

Rekomandimi 5 – Rekomandohet drejtori i drejtorisë së audituar, të siguroj se sektori për taksa komunale të pregadit dhe të i shpërndaj aktvendimet sipas rregullores për taksa komunale nr.01/80 të datës 29.06.2020 neni 21 pika 2. Rekomandohet Kryetari i Komunës dhe drejtori i DEZHT-së që të shqyrtojnë vendimet për falje të borxhit nga ana e komisionit (mundësi anulimi të këtyre vendimeve). Rekomandohet drejtoria e audituar që të ndërmerr të gjitha masat që në të ardhmen të zbatohen vendimet e Kuvendit të Komunës.

Auditimi Nr. 3 Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Çështja 1 - Tek zyrtarët e drejtorisë së shëndetësisë në të gjitha proceset e funksionimit të kësaj drejtorie, ne kemi vërejtur se ka të meta të cilat nuk i referohen dizajnit të një kontrolli të mirë të brendshëm me qëllim të menaxhimit sa më efikas dhe ekonomik të parasë publike.

Gjatë këtij auditimi nuk kemi hasur në një bashkëpunim të mirë me menaxhmentin e kësaj drejtorie, pasi kemi mbajtur takimin fillestar dhe janë njoftuar me objektivat e këtij auditimi, ka qenë një neglizhencë e menaxhmentit dhe stafit tjetër të drejtorisë për ofrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e auditorit të brendshëm, edhe pse kanë pasur kohë të mjaftueshme rreth 30 ditë pune, nuk kanë arritur të sigurojnë dokumentet e kërkuara për

arritjen e objektivave të planifikuara për këtë auditim, gjatë kësaj periudhe kohore kemi mbajtur disa her takime me menaxhmentin e drejtorisë dhe janë diskutuar këto qështje por që rezultati ka munguar.

Nga 19 objektiva të parapara për këtë auditim, nga stafi i drejtorisë për shëndetësi, kemi arritur të marrim dokumente dhe mostra vetëm për 4 objektiva të parapara për këtë auditim. Gjatë këtij auditimi ka pasur një neglizhenc të theksuar nga ana e stafit të drejtorisë për shëndetësi si në bashkëpunim, ofrimin dhe sigurimin e dokumenteve të kërkuara nga ana e auditorit të brendshëm.

Konkluzion: Zyrtarët të cilët kanë qenë të kyçur në procesin e shpenzimeve në Drejtorinë e Shëndetësisë që mallrat dhe shërbimet të shpenzohen sipas procedurave të parapara për shpenzimin e parasë publike dhe zyrtarët tjerë, gjatë këtij auditimi nuk ka qenë një bashkëpunim në nivelin e duhur dhe nuk na janë prezentuar dokumentet e kërkuara në bazë të objektivave të planifikuara për këtë auditim siç janë: mos ofrimi i dëshmive me të dhëna dhe mos prezantimi i shpenzimeve për kujdestaritë e paguara, mos ofrimi i dëshmive me të dhëna me rastin e pranimit të mallrave dhe shërbimeve, mos ofrimi i dëshmive për ekzekutimin e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, mos ofrimi i dëshmive me të dhëna për barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave komunale, mos ofrimi i dëshmive për menaxhimin e kontratave, mos ofrimi i dëshmive dhe mungesa e evidencave analitike për çdo veturë lidhur me shpenzimet e derivateve, mirëmbajtjes dhe servisimeve, mos ofrimi i dëshmive dhe mungesa e procedurave të brendshme për arsyetimin e materialit të harxhuar me shërbimet që ofrohen për qytetarët, mos ofrimi i dëshmive rreth shpërndarjes së barnave etj.

Rekomandimi 1 - Rekomandohet Kryetari i Komunës që të ndërmarrë masa të menjëhershme ndaj menaxhmentit të drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në drejtim të forcimit të kontrollës së brendshme të kësaj drejtorie. Rekomandohet Kryetari i Komunës dhe menaxhmenti i drejtorisë që të bëjnë veprime të menjëhershme korrigjuese për tu mbrojtur nga një ekspozim i tillë me dobësi të ndjeshme të kontrollit.

Auditimit Nr. 4 Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme

Çështja 1 - Mangësi në Planifikimin e të Hyrave. Ne kemi vërejtur se në lloje të ndryshme të të hyrave nuk ishin bërë planifikime adekuate dhe nuk ishin marrë masa të mjaftueshme për realizimin e të hyrave. Kjo vërehet tek ngecja në mbledhjen e të hyrave, i cili plan nuk ishte përmbushur.

Konkluzion: Keq përcaktimi i planifikimit rezulton në pasqyrimin jo të drejtë të të hyrave, dhe rrjedhimisht shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Komunës.

Rekomandimi 1 - Rekomandojmë që Drejtoria e Administratës së Përgjithshme duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në ndarjet adekuate të planifikimit, në mënyrë që të bëhet regjistrimi dhe inkasimi i mirëfillt i të hyrave vetanake.

Çështja 2 - Mangësi në Barazimin dhe Harmonizimin e të Hyrave. Sipas nenit 13 (pika 3.3) e Rregullës financiare 03/2010 – Për të hyrat vetanake OB-ja, është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave në Thesar. Drejtoria përkatëse në komunë duhet që çdo muaj të bëjë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave, përveç regjistrimit të të hyrave vetanake si dhe harmonizimit mujor dhe tremujor në Thesar, kërkohet edhe harmonizimi i të hyrave në mes të departamenteve dhe zyrtarit të të hyrave në Komunë i cili duhet të bëhet për çdo muaj.

Konkluzion: Mos realizimi i barazimeve mujore në mes të drejtorisë për administratë, me zyrtarin e të hyrave rrezikon devijime të caktuara në kontrolle të brendshme duke shkaktuar mangësi të informacionit në kohë, mbi llojet dhe shumatat e të hyrave.

Rekomandimi 2 – Rekomandojmë Drejtorinë e Administratës, duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor për të hyra Komunale të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.

Auditimi Nr. 5 Auditimi i Performancës NDËRTIMI I PARQEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Çështja 1 - Nga dokumentacioni i ekzaminuar dhe analiza e vlerave të projekteve të planifikuara në bashkë financim me DEMOS-in, ne kemi gjetur se projekti i bashkë financiar ishte pjesë e KAB-it për vitet 2021-2023, por komuna e Rahovecit nuk kishte SZHLE. Projekti ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit në KAB për vitet 2021-2023, ishte paraparë sipas renditjes së projekteve me numër 8 por si projekt në grup, në kuadër të projektit „Krijimi i Shesheve të Reja, Parkingjeve dhe Mirëmbajtja e tyre” pa një kosto të këtij projekti.

Vlera e planifikuar me buxhetin e aprovuar për projektin „Krijimi i Hapsirave të Gjellbruara dhe Drunjë Dekorativë,, ka qenë e paraparë 100.000.00€ për vitin 2021, 120.000.00€ për vitin 2022 dhe 170.000.00€ për vitin 2023, në planin e prokurimit për vitin 2021 është paraqitur shuma e planifikuar me buxhetin e vitit 2021, në shumën prej 180.000.00€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës në njoftimin për kontratë ka qenë 346.334.25.00€.

Shkaku: Paraqitja e këtyre dallimeve në mes vlerave për kostot e projekteve kanë të bëjnë me faktin se komuna nuk kishte SZHLE, njësia kërkuese me rastin përgatitjes së planit të prokurimit, ka dorëzuar planifikimin duke u bazuar vetëm në koston e projektit për vitin e parë dhe jo për projektin në periudhën tre vjeçare.

Ndikimi: Shumat e planifikuara me buxhet kan ndikuar që mos të jenë të sakta, kështu që krijohet dallim i madh në mes vlerës së parashikuar që publikohet në njoftimin për kontratë dhe vlerës së planifikuar me plan të prokurimit.

Rekomandimi 1 Rekomandojmë menaxhmentin që të krijohet një praktik e mirë lidhur me pregaditjen e SZHLE strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik, dhe korrigjim e aktivitetëve të pa planifikuara. Rekomandojmë menaxhmentin që të kërkoj nga njësit kërkuese që me rastin e dorëzimit të planifikimit të nevojave për vitin në vijim, të sigurohen se cilat nga projektet financohen për dy apo tre vite me qëllim të planifikimit të saktë të vlerave të planifikuara me planin e prokurimit dhe përfshirjes së projekteve në buxhetin e planifikuar.

Çështja 2 - Projektet e propozuara nga komuna për aprovim në Kuvendin e Komunës duhet të kenë të bashkangjitura vlerësimet sipas kriterëve të UA nr.06/2019. Kriteret kryesore janë: rëndësia strategjike, vlerësimi ekonomik - financiar dhe vlerësimi gatishmërisë së zbatimit të propozim projekteve, Analiza e Zhvillimit Ekonomik - Strategjia e Komunës, Ligji nr. 03 / L-048 për MFPP neni 60, Ligji nr.06/L-021 për KBFB, neni 4 , Ligji për ndarjet buxhetore vjetore, konsultimet publike të kryera për projektet, po ashtu projektet duhet të parashikohen në strategjitë dhe planet komunale dhe të adresojnë nevojat e identifikuara qartë sipas UA-06-2019 kriteret e përzgjedhjes dhe prioritetizimi i projekteve kapitale si dhe analiza e vlerësimit të kriterëve sipas përparësisë. Nga ekzaminimi i PIPAV-e për këtë projekte dhe nga evidencat të cilat i kemi siguruar për pagesat e kryera për vitet 2021, 2022 dhe 2023 si dhe nga defektet të cilat na paraqiten në fazën e kryerjes së punimeve të këtij projekt të cilin e kemi në fushëveprim, ne kemi gjetur se me rastin e planifikimit të buxhetit nuk merren në konsideratë problemet lidhur me pronat të cilat përfshihen në projektet e planifikuara, në raste të tilla mund të paraqiten rrezeq rreth procedurave të shpronsimit të pronave dhe rritjes së koston financiare të projektit.

Shkaku: Me rastin e planifikimit të buxhetit dhe vlerësimit të projekteve sipas kërkesave të UA.nr 06/2019 të MF, zyrtarët që përgatitin PIPA-at dhe regjistrimin e të dhënave në programin e buxhetit nuk kanë informata nga drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, lidhur me ngastrat e përfshira në projektet të cilat vlerësohen për prioritetizim, pra nuk analizohen problemet pronësore dhe marrja në konsideratë e të gjitha kostove rrjedhëse.

Ndikimi: Mos marrja me kohë e informatave rreth pronave ku planifikohet të bëhet investimi ndikon të rrisë koston e projektit.

Rekomandimi 2 - Rekomandohet menaxhmenti i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit me rastin e pranimit të projektit detal të sigurohet nga drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë se parcelat të cilat përfshihen në trasen e projektuar, në rast se ka probleme pronësore të mos fillohet me inicimin e procedurës së prokurimit deri sa të zgjidhën kontestet pronësore.

Çështja 3 - Hapat në të cilët kryhet procesi i prokurimit janë planifikimi i prokurimit, publikimi i njoftimit për kontratë pas pranimit të kërkesës nga njësia kërkuese e cila është e shoqëruar me specifikimin teknik, caktimi i llojit të prokurimit, parashikimi i vlerës për kontratë, përgatitja e dosjes së tenderit, hapja e ofertave, vlerësimi i ofertave, shqyrtimi i ankesave, publikimi i vendimeve të AK, përgatitja e kontratës dhe kushteve specifike të kontratës duke përfshirë edhe planin dinamik për kryerjen e punëve apo furnizimeve, nënshkrimi i kontratës dhe sigurimi i planit të menaxhimit të kontratës nga menaxheri i caktuar nga ZKA për menaxhimin e kontratës, (mungonte kërkesa për mjetet e zotuara). Gjatë procesit të auditimit në dosjen e prokurimit, të projektit „Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit,, kemi gjetur se AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit pa zotim të mjeteve, duke u bazuar në Rregullën Financiare NR.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike, Neni 12 Zotimi i Fondeve.

Shkaku: AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit pa zotim të mjeteve.

Ndikimi: Mos zotimi i mjeteve për këtë projekt në fazën para inicimit të tenderimit, ka ndikuar që projekti të mos përfundohej brenda afatit të paraparë në kontratë, për shkak të mungesës së buxhetit.

Rekomandimi 3 - Rekomandohet, menaxhmenti i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, mos të bëjë kërkesë për inicim të procedurave të prokurimit pa pasur mjete të mjaftueshme të planifikuara me buxhet. Rekomandohet menaxhmenti i Zyrës së Prokurimit që mos të iniciojë procedura të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.

Çështja 4 - Sipas marrëveshjes së nënshkruar për GPK në mes MAPL-së, Komunës së Rahovecit dhe DEMOS-it më datën 01.06.2022, në mesin e 10 projekteve, ishte paraparë edhe projekti Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit i cili është në fushëveprim të auditimit të performancës. Në marrëveshje në nenin 8 afati i realizimit të projektit, në paragrafin 1 të nenit 8 është paraparë që: Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2022, në paragrafin 2 të nenit 8 është cekur: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

Shkaku: Vonesat për përfundim të projektit kryesisht kanë të bëjnë me mungesë buxheti.

Ndikimi: Mungesa e buxheti ka ndikuar që projekti të mos përfundohej brenda afatit siç është parapar me plan dinamik.

Rekomandimi 4 - Rekomandohet drejtori i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, drejtori i drejtorisë për Financa dhe Buxhet si dhe Zyrtari Kyesor Financiar, që të sigurojnë buxhet të mjaftueshëm për këtë projekt dhe të përmbyllet brenda afatit të vazhduar me Sigurim të Ekzekutimit të Tenderit që është 06.03.2024.

Çështja 5 - Për t'iu përgjigjur nën pyetjes më lartë ne kemi kryer vizita në teren në projektin „Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit,, kemi dalur në teren dhe kemi analizuar se a janë kryer punimet sipas projektit detal, paramasës dhe situacioneve të përfunduara, kemi vizituar 6 parqet, që kemi përzgjedhur për mostrim, të cilët i kemi verifikuar se a përputhen punët e kryera me projektin detal dhe situacioneve të përfunduara. Andaj nga kjo vizit konkludojmë se të gjitha punët që janë përfunduar, janë në bazë të projektit detal, paramasës, dhe situacioneve të përfunduara, por për shkak të mos përfundimit të projektit brenda planit dinamik që ishte prej 500 ditësh dhe zgjatjes së tij edhe për (1) një vit, kemi vërejtur se këto parqe nuk janë mirëmbajtur, kanë filluar të thahen drunjët dekorativ dhe të dëmtohet bari.

Shkak: Mos përfundimi i projektit brenda afatit të paraparë me plan dinamik.

Ndikimi: Mos përfundimi i punëve brenda afatit të paraparë me plan dinamik, ka ndikuar që këto parqe të mos mirëmbahen, as nga Komuna as nga Operatori Ekonomik.

Rekomandimi 5 - Rekomandohet drejtori i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit që të përfundohet sa më shpejtë ky projekt dhe të kërkoj nga Operatori Ekonomik që të mirmbaj parqet deri në përfundim të projektit, deri në momentin kur bëhet pranimi teknik i projektit.

Auditimi Nr. 6 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet

Çështja 1 - Në qoftë se analizojmë inkasimin e tatimit në pronë për vitin aktual, për periudhën Janar – Nëntor 2023, që do të duhej të konsiderohet si shkalla e vërtetë e inkasimit të tatimit në pronë, bazuar në të dhënat e raportit, shohim se 83.27 % e tatimit në pronë nga vlera e faturuar për periudhën aktuale është inkasuar, kurse nga vlera e planifikimit ishin inkasuar 125.21%. Tek vlera e planifikimit nuk ishte marr për bazë vlera e faturimit, kjo paraqet një çështje shumë të rëndësishme, pasi një shkallë e inkasimit mbi 83.27 % të vlerës së tatimit në pronë të faturuar për një vitë përkatës, ka dalluar nga planifikimi vjetor për 33.5%.

KONKLuzion: Planifikimi i të hyrave nuk bazohet në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe vlerën e faturuar, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes faturimit, planifikimit dhe realizimit.

REKOMANDIMI 1 - Rekomandojmë që Drejtoria për Financa dhe Buxhet të caktoj planifikim real krahasuar me vlerën e faturuar dhe të mbajnë evidenca të plota dhe të sakta mbi të hyrat.

Rekomandohet departamenti i buxhetit që në të ardhmen ti ketë parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe historikun e realizimit të të hyrave gjatë viteve paraprake.

Çështja 2 - Pas një analize të të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, kemi vërejtur se Komuna ballafaqohet me një vlerë shumë të lartë të të arkëtueshmeve dhe nëse përcjellim trendin e realizimit të tyre nga viti në vitë vërejmë se shuma e të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë shkonë duke u rritur. Gjatë vitit 2023, tatimi në pronë, të arkëtueshmet kishin arritur në shumën prej 1,544,682.84 € në objekte, dhe 778,448,57 € në parcela, gjithësejt: 2,323,131.41 €. Gjatë vitit 2023, Drejtoria për Financa dhe Buxhet (zyra e tatimit në pronë) nuk kishin marrur masat e duhura për inkasim të detyrueshëm të borxheve.

KONKLuzion: Drejtoria për Financa dhe Buxhet duhet të ndërmerr masa të menjëhershme për inkasimin e të arkëtueshmeve, të përdor politika të qarta dhe të përdor mekanizmat e duhur për inkasim të detyrueshëm, Drejtoria për Financa dhe Buxhet (zyra e tatimit në pronë) duhet të ket parasysh se mund të futen në borxhe të kqia dhe gjithnjë e më shumë të zvogëlohen gjasat që të inkasohen këto borxhe.

REKOMANDIMI 2 - Rekomandojmë drejtorin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet si dhe menaxherin e zyrës së tatimit në pronë, që menjëher të përdorin mekanizmat ligjor, që përmes përfaqësuesit ligjor të Komunës të inicoj procedura përmbartimore për inkasim të detyrueshëm të borxheve.

Rekomandohet drejtori drejtorisë se duhet shtuar kontrolla e brendshme në departamentin e tatimit në pronë dhe të shtohen burimet njerëzore adekuate në këtë departament, departamenti i tatimit në pronë të ketë zyrtarin për inkasim të detyrueshëm.

Çështja 3 - Sipas nenit 13 pika 3 e Rregullës financiare 03/2010 – për të hyrat vetanake OB-ja, është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave në Thesar. Drejtoria përkatëse duhet që çdo muaj të bëjnë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave. Përveç regjistrimit të të hyrave vetanake si dhe harmonizimit mujor dhe tremujor në Thesar, kërkohet edhe harmonizimi i të hyrave në mes të Departamenteve dhe Zyrtarit të të Hyrave në Komunë i cili duhet të bëhet për çdo muaj. Drejtoria e audituar nuk ka arritur të bën barazimin e të dhënave duke përfshirë saldot mujore për të hyrat, nuk janë harmonizuar në mënyrë sistematike (çdo muaj) gjatë periudhës Janar – Nëntor 2023, me zyrtarin kryesor për të hyra.

KONKLuzion: Mos realizimi i barazimeve mujore ne mes te drejtorisë komunale me zyrtarin e te hyrave rrezikon në kontrole të brendshme, duke shkaktuar mangësi mbi llojet dhe shumat e të hyrave.

REKOMANDIMI 3 - Rekomandojm Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, e cila realizon të hyra nga tatami në pronë dhe taksat e automjeteve, të bëjë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore, bazuar në raporte të ndërsjella, duke eliminuar me kohë dobësitë apo gabimet e mundshme.

Çështja 4 - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L-048 parasheh: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Bazuar në listen e obligimeve të cilat i ka paraqitur Drejtoria për Financa dhe Buxhet në muain Dhjetor 2023, rezulton që 135 raste të faturave për pagesë e kanë kaluar afatin ligjor prej 30 ditësh. Shuma totale e faturave të papaguara arrin shifren prej: 1,636,041,79 €.

KONKLuzion: Hyrja në obligime pa buxhet të mjaftueshëm e zyrtarëve të drejtorisë për Financa dhe Buxhet, duke mos realizuar pagesat brenda afatit ligjor, mund të rrezikoj në pagesa përmes procedurave përmbarimore.

REKOMANDIMI - 4

Rekomandojm Drejtorinë për Financa dhe Buxhet dhe ZKF-në, që të forcojnë mekanizmat e kontrollës së brendshme rreth menaxhimit të pagesave dhe të respektoj afatet ligjore për pagesa, në atë mënyr që mos të hyhet në obligime pa fonde të mjaftueshme, dhe se të gjitha faturat të paguhen brenda afati 30 ditësh të parapar me nenin 39.1 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Çështja 5 - Rregulla Financiare NR.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike. Gjatë analizës së shpenzimit të parasë së imët, fletë pranimi standard i parasë së imët, në emër, Drejtoria e Financave, përshkrimi i blerjes (foli e hollë), në emër të blerjes foli e hollë kemi tri (3) pagesa në emër të një furnitori, për shërbimin e njejtë dhe me datë të njejtë, me vlerë totale 296,50 €, të ndarë në tri (3) fatura me shumat: 90 €, 90 € dhe 98.50 €.

KONKLuzion: Konkludojmë se nuk është zbatuar rregulla financiare Nr.01/2013/ MF Shpenzimi i Parave Publike, neni 29 pika 7, ku thuhet se organizata buxhetore nuk mund të pranoj fatura të shumëfishta nga një furnitor për të zvogëluar shumën e faturave individuale në më pak se 100 Euro me qëllim të realizimit të një pagese.

REKOMANDIMI 5 - Rekomandojm Drejtorinë për Financa dhe Buxhet dhe ZKF-në, që të forcojnë mekanizmat e kontrollës së brendshme rreth shpenzimit të parasë së imët dhe të zbatohet në përpikmëri rregulla financiare Nr.01/2013/ MF, neni 29 i kësaj rregulle, me pikat: 1,5,6 dhe 7, të cilat përcaktojnë shumën që mund të shpenzohet, dhe si mund të shpenzohet paraja e imët (petty cash).

Udhëheqësi i NJAB-së
Ruzhdi Kabashi





RAPORTI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022

Nr	Komponent a e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtar përgjegjës	Data e planifi- kuara e zbatim it të rekom- andimi t	Koment e
1.	Çështja A1 Parregullsi në procedurat e prokurimit publik	Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen nga ofertuesit për të fituar kontratë publike. Me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet vlera (përqindja) dhe afati kohor i sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmblotshjen e kontratës dhe është parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës. Neni 36 i LMFP përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Gjithashtu, pika 70.10 e Rregullores 001/2022 për prokurimin publik, përcakton se pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kycet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet të krijojë planin për menaxhimin e kontratës. Parregullsitë e hasura të procedurës së prokurimit Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Kontratat publike të mos nënshkruhen pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK dhe pa sigurim të ekzekutimit në afatin e përcaktuar. Planet e menaxhimit të përgatiten menjëherë pas nënshkrimit të kontratës	Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi sa më efektiv i Vlerësimit të tenderave me komisionet për vlerësimin e ofertave. Sigurimi i ekzekutimit do të zbatohet sipas dosjes së tenderit për vitin 2023	Zyra e prokurimit dhe drejtoritë përkatëse, menaxheret e kontratave	2023	
				Planet e Menaxhimit të kontratave me kohë nga			

rrëth-rrotullimi deri në dalje të rrugës për Xërxë, në vlerë
1,222,222€, janë:

- Në njoftimin për kontratë ishin kërkuar që kopjet e noterizuara të diplomave për stafin profesional, të prezantohen nga vet inxhinierët te noteri. Noterizimi i dokumenteve nuk ishte bërë nga vetë inxhinierët para noterit, por nga përfaqësuesi i kompanisë. Gjithashtu, noterizimi i diplomës për menaxherin e projektit, nuk ishte bërë nga dokumenti original, por nga kopja e zakonshme, dhe noteri në shkresën e tij konfirmon se dokumenti original nuk i është prezantuar.
- OE që ka fituar këtë tender, ka ofruar për menaxherin e projektit referencë për përvojën e punës 4 vjeçare, por në CV-në e nënshkruar nga inxhinieri, nuk prezantohet se ka përvojë pune te kjo kompani. Në njoftim për kontratë ishte kërkuar që menaxheri të ketë së paku 7 vite përvojë pune, referencat e punës nga punëdhënësit, dhe CV të jetë e nënshkruar nga inxhinieri.
- Çertifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, dhe ISO 45001-2018, ishin kërkuar kopje nga origjinali, ndërsa janë ofruar të noterizuara nga kopja e zakonshme. Noteri në shkresat e tij, konfirmon se dokumenti origjinal nuk i është prezantuar.
- Me njoftimin për kontratë është kërkuar që plani i menaxhimit të trafikut të jetë i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Planin e menaxhimit që e ka ofruar kompania është vënë vetëm nënshkrimi, por je edhe emri dhe mbiemri për të përcaktuar se është nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Kontraktuesi nuk kishte dëshmi në ofertën e tij që ka inxhinier të komunikacionit. Parregullsitë e hasura te procedura e prokurimit Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit, në vlerë 272,350€, janë:
- OE me çmimin më të lirë të ofertuar prej 243,020€, ishte eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyen se kishte ofruar listën e panënshkruar dhe të pavulosur të projekteve të realizuara. Megjithatë, OE që është

Menaxherët e
Kontratave

		eliminuar kishte ngarkuar në ofertën elektronike në sistemin e-prokurimi listën e nënshkruar dhe të vulosur të projekteve të realizuara. • Fituesi i tenderit ka ofruar sigurinë e ekzekutimit të kontratës me afat të vlefshmërisë dy muaj më pak se sa është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.			
		• Nuk ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës Te procedura e prokurimit Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit, në vlerë 3,817,348€, siguria e ekzekutimit të kontratës në vlerë 381,734€ ishte bërë për afatin 365 ditë, e jo për 990 ditë, si është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.			
		Te procedura e prokurimit Ndërtimi i objektit të SH.F.M.U "Hamëz Thaqi" në Xërxë, në vlerë 1,575,679€, siguria e ekzekutimit në vlerë 157,567€ ishte bërë për afatin 365 ditë, e jo për 510 ditë, si është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.			
		Për kontratën publike Furnizimi i shkollave me teknologji informative - tabela digjitale, në vlerë 54,700€, zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë 2 muaj pas nënshkrimit të kontratës, dhe se nuk ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës.			
		Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit, në procesin e vlerësimit të tenderëve, dhe pakujdesia e menaxherëve të kontratës.			
2.	Çështja A2 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përbarimore	Neni 40.1 i LMFPF, përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguaje çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Si pasojë e pagesave nga vendimet gjyqësore / përbarimore, Komuna e Rahovecit ka paguar në emër të kamatave dhe procedurave të vlerën prej 71,479€. Në	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollt në	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	Drejtoritë përkatëse
					2023

		total pagesat përfshirë borxhin kryesor dhe kamatat ishin 304,560€. Nga kjo shumë, për paga e mëditje ishin paguar 171,928€, për mallra e shërbime 15,188€, dhe për investime kapitale 117,442€.. Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, dobësive në menaxhim të kontratave, paqartësisë ligjore për pagesën e shujtave dhe pagave jubilarë, etj.	mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.			
3.	Çështja B1 - Urdhërblert et pas pranimit të faturës apo pranimit të furnizimeve dhe punëve	Neni 22 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i parashë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblertja ti paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve. Në 8 pagesa për investime kapitale në vlerë totale 316,393€, dhe 11 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 111,365€, zotimet dhe urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të faturave apo pas pranimit të furnizimeve dhe punimeve. Vonesat në përgatitjen e urdhërblertjeve nga data e pranimit të faturave ishin nga 14 ditë deri 514 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në përgatitjen e urdhërblertjeve me kohë në SIMFK.	Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blerjeve apo porosisë për punë, furnizime dhe shërbime dhe punë të kontraktuara ti paraprijë përgatitja e zotimit dhe aprovimi i urdhërblertjeve në SIMFK.	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	Drejtoria përkatëse dhe Zyra e Prokurimit.	2023
4.	Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Nga auditimi i pagesave kemi identifikuar se obligimet ndaj kontraktuesve nuk ishin realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Kjo është hasur në 28 pagesa për investime kapitale në vlerë 1,143,154€, 16 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 128,92€, dhe një pagesë në vlerë 1,864€ nga kategoria e subvencioneve. Vonesat ishin nga 2 javë deri 17 muaj. Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore.	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda afatit kohor ligjor.	Me zbatimin e rregullores financiare nr.01/2013, gjatë vitit 2023, vlerësojmë se ky rekomandim nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet. Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurimit.	2023

5.	Çështja B3 - Garancioni i punimeve jo në afatin e duhur	Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, në nenin 39.1, parasheh që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021 ishin kryer pagesa në shumën 2,523,472€ apo 1,165 raste të pagesave nga lista e furnitorëve, të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite. Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor, që kanë rezultuar dhe mund të ndikojnëherit në shtimin e numrit të realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.			
6.	Çështja A3 - Ndarje jo e duhur e detyrave	Sipas nenit 38 të Rregullores MF-Nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëheqësi përcakton ndarjen e detyrave që ndanë operacionet dhe përgjegjësitë për zbatimin e dy ose më shumë fazave të një procesi ose aktiviteti në mes të punëtorëve të ndryshëm. I njëjti punëtorë nuk mund të jetë përgjegjës njëkohësisht për miratim, zbatim, kontabilitet dhe kontroll. Në komisionin e vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive dhe OJQ për vitin 2022, një anëtar i komisionit përbëhej nga zyrtari certifikues. Kjo ka ndodhur për shkak mos veprimit në përputhje me kërkesat ligjore për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me kërkesat dhe procedurat e MFK-së, ashtu që i njëjti zyrtar të mos merr pjesë në dy apo më shumë faza të procesit.	Rekomandim i zbatuar	Drejtoria për Kulturë,Rini dhe Sport dhe komisioni për vlerësimin e kërkesave (aplikacione ve).	2023
7.	Çështja B4 Vonesa në realizim të projekteve kapitale	Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet afati kohor i realizimit të projekteve. Vonesa në realizim të projekteve kapitale janë hasur te kontratat: • Ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve në fshatin	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuar të aplikohen penalet e parapara me kontratë.	Deri në fund të vitit fiskal, ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet, e në vitet në vazhdim, plotësisht do të zbatohet.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, zyra e prokurimit dhe drejtoritë përkatëse	2023

	Ratkoc, në vlerë 468,298€, e nënshkruar në muajin nëntor 2018, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Projekti nuk ishte përfunduar deri në fillim të muajit dhjetor 2022.								
	- Ndërtimi i kanalizimeve ne komunën e Rahovecit, ne vlerë 441,156€ dhe aneks kontrata ne vlere 40,530€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2020, ndërsa ka zgjatur deri në maj 2022. - Riparimi i monumenteve kulturore - historike, Lot 2, e nënshkruar me datë 20.09.2021, në vlerë 130,016€ ishte planifikuar të realizohej për 430 ditë. Deri në dhjetor 2022 ishin realizuar 36% e punimeve të kontraktuara. - Ndërtimi i tregut ditor në fshatin Ratkoc, në vlerë 69,997€ është nënshkruar e date 18.06.2021, me afat të realizimit prej 120 ditëve, ishte realizuar me 6 muaj vonesë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave publike dhe mungesës së mjeteve buxhetore.								
8.	Çështja C1 - Klasifikimi i joadekuat i shpenzimeve	Me planin kontabël definohet se shpenzimet duhet të regjistroheshin në kategoritë adekuarte ekonomike. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve përshkruan qartë definicionet e kategorive ekonomike që i përdor Thesari për të regjistruar dhe raportuar shpenzimet. Paga e faturës në vlerë 7,000€ për furnizim me material ndërtimor për 13 renovimin e shtëpi të komuniteteve jo-shumicë, ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale, ndonëse shpenzimi i takon kategorisë së subvencioneve. Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të shpenzimit në kategorinë përkatëse ekonomike.	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në kategoritë adekuarte të buxhetit apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme, dhe që pagesa e shpenzimeve të realizohet nga buxheti i kategorisë adekuarte ekonomike.	Do të zbatohet ky rekomandim sepse pagesat për kategori të shpenzimeve do të bëhen nga kodet adekuarte (subvencione dhe transfere) dhe jo nga kategoria investime kapitale.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa,Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse plotësisht,	2023		
9.	Çështja A4 - Parregullsia	Sik shpjegohet me pikën 54.15 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, Kurdo që Autoriteti kontraktues (AK) nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për	Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse plotësisht,	Drejtoria përkatëse				

në menaxhimi në kontratave publike të kontraktuar përmes procedurës me çmim të poentuar (peshuar)	njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani +/- 30%. Gjithashtu, në shpëligimin nr. 68, të KRPP-së, përcaktohet se AK duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, por të ruajnë të njëjtin raport. Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit gjatë kontraktimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët. Gjatë realizimit të (3) tri kontratave publike me çmim të poentuar, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuara të kategorisë, dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Rastet janë hasur te: • Kontrata publike Hartimi i projekteve te ndryshme, me vlerë totale të parashikuar 350,000€, janë përcaktuar 7 kategori ku secilës kategori i është përcaktuar pesha apo përqindja e shpenzimit. Për kategorinë I.G - Projektimi i urave, mbikalimeve, trotuareve, etj. e peshuar 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 35,000€, vetëm për situacionin e parë të punimeve, për këtë kategori ishin shpenzuar 212,004€ apo 61% e vlerës së përgjithshme të kontratës, duke tejkaluar me 51% vlerën e parashikuar. Kjo kategori kishte çmimin më të lartë 3.08€ të peshuar në krahasim me kategoritë tjera (0.11€, 0.13€, 0.16€, 0.12€, 1.73€). Kontrata është fituar nga OE që ka ofruar çmimin e peshuar më të ulët, përderisa realizimi i 61% të kontratës është bërë për kategorinë me çmimin më të lartë. • Kontrata publike, Mbikëqyrja e investimeve kapitale, në vlerë totale të parashikuar 80,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë E- projekte të objekteve	procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	pjesërisht do të zbatohet gjatë vitit 2023	dhe Zyra e Prokurimit.
--	--	--	---	-------------------------------

					ndërtimore të ndryshme, e peshuar 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 8,000€, ishin shpenzuar 62,085€ apo 78% e vlerës së përgjithshme të kontratës. • Kontrata publike, Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, në vlerë totale të parashikuar 150,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilin kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë 1 - shenjëzime horizontale të komunikacionit, e peshuar 22% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 33,000€, ishin shpenzuar 84,623€ apo 56% e vlerës së përgjithshme të kontratës. Gjithashtu, këto kontrata gabimisht ishin konsideruar kontrata publike kornizë, ku devijimi i lejuar është përcaktuar +/- 30%, ndonëse te kontratat publike me peshim nuk vlen pragu +/- 30% . Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontrolleve adekuate në menaxhimin e kontratave.
--	--	--	--	--	--



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 (njëzet e pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraparak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 198/24 i datës 29.02.2024.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Besmirë Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. **Afrim Oruqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. **Ilir Pallqa**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës –LVV;
 - 2.4. **Sejfullah Sejfullahu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – PDK;
 - 2.5. **Adelina Paqarizi**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 (njëzet e pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit, i cili përfshinë: emrin, përshkrimin, sipërfaqen, destinimin, dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim; afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës; veprimtarinë që mund të ushtrohet; afatin e fundit për aplikim; vendin ku bëhet pranimi i ofertave për shprehje të interesit; si dhe informacionet shtesë.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.199/24
Datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik dhe juridik deri në 25 (njëzet e pesë) vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht vendosjen e paneleve solare, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2

Pronat e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij vendimi janë:

1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02302-1 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur ravne shume, me kulturë Kullosë e klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 162513m² (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e trembëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02299-0 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur grot, me kulturë Arë e klasës 7, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6806 m² (gjashtëmijë e tetëqind e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

Neni 3

Çmimi fillestar i pronave komunale të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 1.5cent/m² në muaj (një pikë zero pesë cent për metër katror), në shumën e përgjithshme prej 2,539.78€ (dymijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e tetë cent) në muaj. Realizimi i pagesës në qira fillon pas 36 muajve.

Neni 4

OBLIGOHET Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur përmes shprehjes së interesit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në

Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.198/24
Me datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërtimeve dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.15 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit

1. Me këtë vendim bëhet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe lista me emërtimet e reja të listës rezervë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetari të Komunës,**
- **MAPL-së dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.197/24
Me datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Shkresës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me Nr. Prot. 31-1/2024, e datës 2.2.2024, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01, Nr. 174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024

1. Me këtë vendim, **shfuqizohet** vendimi me Nr. Prot. 01, Nr. 174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.196/24
Datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"*), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"*), nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 10, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.4, nenit 34 dhe nenit 40, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01, Nr. 325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01, Nr. 325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim.
2. Pika 3.4 e vendimit bazik, me Nr. Prot. 01, Nr. 325/22, i datës 31.5.2022, ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:

1.2.Sejfullah Sejfullahu, emërohet anëtar i Komitetit për Komunitete.
3. Ndërsa pikat e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 01, Nr. 325/22, i datës 31.5.2022, mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.195/24
Datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit